



Agjencia Shtetërore  
për **Mbrojtjen** e të  
Drejtave të **Fëmijëve**

Raporti i Punës së  
Agjencisë Shtetërore  
për të Drejtat dhe  
Mbrojtjen e Fëmijës  
dhe i strukturave të  
mbrojtjes së  
fëmijëve

Viti 2017

## Përmbajtja

Lista e shkurtimeve .....	3
HYRJE .....	4
Përmbledhje Ekzekutive .....	5
KAPITULLI I - KUADRI LIGJOR.....	9
1.1 Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” .....	9
1.2 Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017- 2020 .....	10
1.3 Aktet nënligjore të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” .....	12
KAPITULLI II - KUADRI INSTITUCIONAL.....	12
2.1 Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë.....	13
2.2 Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe vendor.....	14
KAPITULLI III - MONITORIMI I MEDIAS LIDHUR ME PROBLEMATIKAT E MBROJTJES SË FËMIJËVE.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
KAPITULLI IV- TË DHËNA SHIFRORE MBI RASTET E FËMIJËVE NË RREZIK .....	16
4.1 PMF dhe raportimi ndër vite.....	16
4.2 Profili dhe roli i PMF-ve.....	17
4.3 Numri i PMF sipas numrit të rasteve të raportuara .....	18
4.4 Raste të menaxhuara në total nga PMF.....	19
4.5 Rastet e reja të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë .....	20
4.6 Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve .....	21
4.7 Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut.....	22
4.8 Rastet e mbyllura .....	23
KAPITULLI V - PROBLEMATIKAT, NATYRA E RREZIKUT DHE LLOJET E ABUZIMIT .....	23
5.1 Problematikat e rasteve të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve .....	24
5.2 Abuzimi i fëmijëve .....	28
KAPITULLI VI - NDËRHYRJET, SHËRBIMET E OFRUARA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE. ....	32
6.1 Ndërhyrjet dhe shërbimet.....	32
6.2 Funkionimi i grupit teknik ndërsektorial (GTN) .....	35
6.3 Vizitat në familje.....	37

6.4 Problematikat e raportimit dhe punës për menaxhimin e rasteve .....	38
KAPITULLI VII- FËMIJËT NË SITUATË RRUGE .....	40
7.1 Kuadri ligjor për fëmijët në situatë rruge.....	40
7.2 Identifikimi dhe menaxhimi i fëmijëve në situatë rruge .....	42
7.3 Unifikimi i databazës për fëmijë në situatë rruge .....	47
7.4 Aktivitete.....	47
7.5 Trajnime.....	49
7.6 Problematikat dhe pikat e forta .....	49
KAPITULLI – VIII AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS .....	52
8.1 Aktivitete ndërgjegjësuese .....	52
8.2 Aktivitete informues për prezantimin e kuadrit të ri ligjor .....	55
8.3 Raportimet ndërkombëtare.....	56
KAPITULLI IX - REKOMANDIMET .....	57

## Lista e shkurtimeve

<b>AKDF</b>	Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijës 2017-2020
<b>ASHDMF</b>	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>NE</b>	Ndihmë Ekonomike
<b>NJMF</b>	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
<b>PMF</b>	Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit
<b>OJF</b>	Organizatë Jo-fitimprurëse
<b>PVF</b>	Plani i Veprimit për Fëmijët
<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>VKM</b>	Vendimi i Këshillit të Ministrave

## HYRJE

Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore jo vetëm e institucioneve që punojnë me dhe për fëmijët por e gjithë shoqërisë. Vëmendja e politikës dhe institucioneve është krijimi i një mjedisi me kushte të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psikosocial të fëmijëve që si mision kryesor ka mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Krijimi i një të ardhme të sigurt, me standarde të larta jetese, familje të shëndetshme që mundëson mirërritje dhe zhvillim, është objektiv kryesor i qeverisë shqiptare. Puna për vitin 2017 është fokusuar drejt krijimit të një sistemi efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, që garanton të drejtat dhe siguron mbrojtjen e tyre nga të gjitha format e dhunës në përmbushje të parimeve të bashkëpunimit ndërsektorial. Gjithashtu ky sistem efektiv ka si qëllim të forcojë aftësinë reaguese të strukturave dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Miratimi i Ligjit të ri 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” konkretizoi përpjekjet për ngritjen e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve. Ligji ka për qëllim të përcaktojë të drejtat, aksesin në të drejta, mekanizmat konkrete dhe efektive që garantojnë realizimin me efektivitet të këtyre të drejtave .

Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. Ajo mbledh të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës. Në këtë funksion Agjencia i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës. Agjencia propozon udhëzime metodologjike për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore dhe koordinim ndërsektorial në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, në nenin 42, paragrafi 4 parashikon detyrimin e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës që brenda tremujorit të parë të çdo viti t’i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Ky raport hartohet në bazë të dhënave statistikore dhe informacioneve për situatën e mbrojtjes së Fëmijëve, që NjMF-të raportojnë çdo tre muaj dhe një herë në vit pranë Agjencisë.

Për hartimin e këtij raporti ka punuar stafi i ASHDMF.

## Përmbledhje Ekzekutive

Raporti jep një panoramë të qartë të punës së NJMF/PMF dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2017. Viti 2017 ka qënë një vit intensiv përse i përket punës së bërë me hartimin e kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, njohjen dhe zbatimin e tij.

Çdo kapitull është strukturuar në mënyrë që të paraqesë situatën aktuale, progresin e bërë, si dhe identifikojë problematikat e konstatuara dhe sfidat për realizimin e plotë të drejtave dhe mbrojtjen efektive të fëmijëve.

Kapitulli i parë i raportit flet për legjislacionin dhe hartimin e politikave të reja për vitin 2017. Kapitulli i dytë fokusohet tek mekanizmat këshillimore dhe koordinues institucionalë si dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe vendor.

Kapitulli i tretë flet për monitorimin e media nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës e cila ka identifikuar dhe adresuar problematikën e shkeljeve etike dhe të të drejtave të fëmijës gjatë raportimit të rasteve të fëmijëve në media, të cilat nuk respektojnë privacinë dhe anonimitetin për fëmijët. Në kapitullin IV, V dhe VI të këtij raporti jepen të dhëna shifrore mbi rastet e menaxhuara nga NJMF/PMF të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë, të dhëna lidhur me numrin e NJMF/PMF profilin e tyre, ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, problematikat, natyrën e rrezikut dhe llojet e abuzimit. Tabela e mëposhtme jep një informacion të përmbledhur të këtyre kapitujve.

Tabelë përmbledhëse 2017<sup>1</sup>

	Viti 2017
<b>NJMF zyrtare</b>	<b>223</b>
<b>Informacion mbi funksionimin e NJMF</b>	
Punonjës që kryejnë funksionin vetem si PMF	45
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe administrator social	79
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialist të dhunës në familje	9
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë për personat me aftësi të kufizuar	30
Punonjës që kryejnë detyrën si PMF dhe specialistë të barazisë gjinore	12

<sup>1</sup> Tabela përmban të dhëna dhe informacion të përmbledhur (2017) mbi numrin e njësisve të mbrojtjes së fëmijës, profilin e formimit të tyre, numri i masave të mbrojtjes, numri i Planeve Individuale të Mbrojtjes raportimin sipas numrit të rasteve të menaxhuara sipas problematikave dhe llojit të abuzimit, nivelet e rrezikut dhe mënyrës së identifikimit dhe referimit të rasteve. Gjithashtu janë përfshirë të dhëna për fëmijët në situatë rruge dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve.

Punonjës kryejnë detyrën si PMF dhe funksione të tjera (që nuk përfshihen më sipër)	46
Punonjës që kryen detyrën si PMF dhe administrator i njësisë	2
<b>Profili I PMF</b>	
Punë Sociale	78
Nuk ka informacion	59
Nuk janë Punë Sociale	86
NJMF që kanë raportuar	133
NJMF që kanë raportuar 0 raste	56
NJMF që kanë raportuar të paktën 1 rast	77
Raste të menaxhuar në total	1650
Numri i rasteve të reja	929
0-6 vjeç	362
7-15 vjeç	477
16-18 vjeç	90
<b>Numri i Planeve Individuale të Mbrojtjes të hartuara nga NJMF/PMF</b>	705
<b>Numri i masave të mbrojtjes të marra me vendim të drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore të propozuara nga NJMF/PMF/drejtori i NJMF të</b>	
Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative	20
Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative	12
Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar	3
<b>Numri i masave të mbrojtjes të vendosura nga gjykata e rrethit gjyqësor të</b>	
Masa emergjente e mbrojtjes, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative	9
Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative	3
<b>Numri i rasteve të reja sipas gjinisë</b>	
Femra	455
Meshkuj	474
<b>Numri i rasteve të reja sipas përkatësisë etnike</b>	
Rom	256
Egjiptian	229
Te tjere	1
<b>Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve</b>	
NJMF	327
Policia	101

OJF	156
Prindi	101
Fëmija	11
Institucione arsimore	45
Institucione shëndetësore	19
Administratori i NE	31
Të tjerë	138
<b>Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut</b>	
Nivel i ulët	622
Nivel i mesëm	689
Nivel i lartë	261
Emergjent	78
<b>Rastet e mbyllura</b>	
fëmija është mbi 18 vjeç	44
është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku	284
fëmija jashtë rrezikut deri 18 vjeç	24
fëmija vdes	1
fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër	145
Total i rasteve të mbyllura	498
<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje, sipas problematikave</b>	
dhunë në familje	286
trafikim	15
shfrytëzim fëmije	387
probleme ekonomike	672
aftësi e kufizuar	29
mosregjistrim	51
braktisje shkollore	80
Tjetër	130
<b>Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit</b>	
Abuzim fizik	189
Abuzim seksual	39
Abuzim psikologjik	290
Neglizhim	683
<b>Raste të referuara nga Agjencia</b>	
Raste të referuar pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijëve - të identifikuar në media nga ASHMDF	117
Ankesa zyrtare tek AMA	10
Sinjalizime tek operatorët mediatike lidhur me shkeljet e konstatuara	31
<b>Të dhëna për femijet në situatë rruge</b>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Viti 2017</b>



Skuadra terreni për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge në bashkitë Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë, Krujë dhe Kavaje	29
Fëmijë në situatë rruge të identifikuar	484
Fëmijë të cilët janë në proces menaxhimi	352
Fëmijë që janë regjistruar dhe frekuentojnë shkollën	208
Prindër të fëmijëve në situatë rruge të punësuar	36
Raste të fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale	27
Raste të fëmijëve që janë shoqëruar në shërbimet shëndetësore	19
Fëmijë që janë trajtuar me shërbime në qendrat e emergjencës në gjithë vendin	81
Fëmijë që janë regjistruar në gjendje civile	24
NJMF që e kanë mbledhur GTN të paktën një herë	50
Nr i rasteve për të cilat është bërë vizita në familje	352
<b>Ngritje e kapaciteteve të strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve</b>	
Trajnimet në dy bashki për Procedurat e identifikimit dhe referimit të fëmijëve në situatë rruge j	60 punonjës
Trajnimet në 2 bashki për Procedurat e menaxhimit të rastit	60 punonjës
Trajnime në 7 bashki për profesionistë të cilët punojnë për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi që kishte për qëllim përgatitjen dhe informimin e profesionistëve të kuadrit të plotë ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi si dhe parashtrimi i rasteve konkrete në proces menaxhimi nga PMF.	180 profesioniste

Kapitulli VII i raportit trajton punën e bërë nga NJMF/PMF dhe ASHDMF lidhur me fëmijët në situatë rruge. Identifikimi, menaxhimi, kuadri ligjor për trajtimin e rasteve si dhe aktivitetet ndërgjegjësues, janë disa nga temat që trajtohen në këtë kapitull.

Një kapitull i veçantë në këtë raport, kapitulli VIII, i është dedikuar aktiviteteve të kryera nga ASHDMF përgjatë vitit 2017, në bashkëpunim me NJMF/PMF dhe partnerët.

Në fund të raportit, në kapitullin IX jepen rekomandimet për përmirësimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

## KAPITULLI I - KUADRI LIGJOR

### 1.1 Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Në shkurt të vitit 2017 u shënuar një arritje e rëndësishme në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri me miratimin e Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, i cili hyni në fuqi në qershor të vitit 2017. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ligji Nr.10347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, shfuqizohet. ASHDMF ka udhëhequr procesin e hartimit të ligjit, organizimin e takimeve konsultative dhe reflektimin e komenteve. Ligji sjellë një tjetër qasje ndaj mënyrës se si garantohen të drejtat e fëmijës, si dhe vendos fokusin në ngritjen e një sistemi të integruar të mbrojtjes duke propozuar ndërhyrje dhe masa konkrete të mbrojtjes që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhimit ose potencialisht i tillë.

Ligji trajton për herë të parë aspektin e mbrojtjes së fëmijëve, gjë që reflektohet që në titull dhe më pas shtjellohet duke parashikuar masat mbrojtëse që jepen nga strukturat e pushtetit vendor dhe gjykata. Në këtë drejtim ligji shkon drejt standardeve më të përparuara evropiane, për të garantuar mbrojtjen e fëmijës në çdo situatë, brenda familjes, në institucione, online, etj.

Në ligj është parashikuar për herë të parë kuptimi i detajuar dhe mënyra e zbatimit në praktikë të parimit të interesit më të mirë të fëmijës, i cili tashmë duhet të zbatohet në mënyrë të unifikuar nga të gjitha organet ligj zbatuese që kanë në qendër fëmijën.

Është vendosur e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor ose procedural dhe në praninë e detyrueshme të psikologut. E drejta e fëmijëve për t’u dëgjuar duhet të respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, lidhur me këtë të drejtë është parashikuar dhe mundësia e përfaqësimit të tyre në Këshillin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve. Ligji parashikon për herë të parë një sistem gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijëve duke ripërcaktuar qartë detyrat e mekanizmave institucionale dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe në nivel lokal, duke koordinuar edhe me ligjin e ri për shërbimet sociale si dhe realitetin e ri ligjor dhe administrativ të ndarjes territoriale të vendit.

Një risi shumë e rëndësishme është parashikimi i detyrimit për raportim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshi ata në rrezik. Ky detyrim parashikohet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët pavarësisht përcaktimeve ligjore, të cilat ndodhen për disa kategori në akte të tjera ligjore.

Për herë të parë parashikohen masat për riaftësimin prindëror, duke synuar respektimin e standardeve të të drejtave të fëmijëve për kthimin e tyre pranë familjes, nëse janë vendosur në

përkujdesje alternative, duke fuqizuar dhe mbështetur familjen apo duke ndërhyrë për përmirësimin e marrëdhënieve familjare nëse fëmija vazhdon të trajtohet brenda familjes.

Ligji ruan dhe zhvillon më tej konceptin që mospërbushja e detyrimeve të vendosura nga ky ligj për çdo institucion, strukturë në nivel qendror apo vendor, apo detyrimi për bashkëpunimin institucional, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, e cila vendoset nga Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

## 1.2 Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017- 2020

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 372, datë 26.04. 2017 u miratua Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 - 2020 (në vijim Agjenda) shpreh angazhimin e qeverisë shqiptare për promovimin, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Agjenda synon të përmbushë këtë mision duke iu përmbajtur/integruar standardeve më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Ajo synon përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve duke synuar përforcimin e kuadrit rregullator dhe institucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje. AKDF përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve. Angazhimi për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve konfirmohet si një prioritet i rëndësishëm i qeverisë, nëpërmjet një qasjeje të integruar sistemime. Kjo Agjendë përmban tre shtylla strategjike:

- (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- (ii) Eleminimi i të gjitha formave të dhunës për fëmijët; dhe
- (iii) Sisteme dhe Shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndetësia dhe ushqyerja, dhe mbrojtja sociale.

AKDF synon përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve duke synuar përforcimin e kuadrit rregullator dhe institucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje.

Angazhimi për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve konfirmohet si një prioritet i rëndësishëm i qeverisë, nëpërmjet një qasjeje të integruar sistemike. AKDF synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar ndjeshëm. Objektivat dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve janë hartuar në përputhje me Dokumentin e politikave “E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri”<sup>2</sup>.

Në pjesën e tretë AKDF synon nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore, dhe drejtësi. Në këtë aspekt është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Qasja e përdorur si bosht për agjendën është ajo e të drejtave të fëmijëve. Kjo qasje e konsideron çdo fëmijë një qenie njerëzore unike dhe njëloj të vlefshme, mendimi i të cilit/ës duhet të dëgjohet në të gjitha situatat vendimmarrëse për të, përfshirë këtu dhe proceset gjyqësore, që ka të drejtë jo vetëm për të jetuar dhe mbijetuar por për zhvillim deri në arritjen e potencialit të vet maksimal, që ka të drejtë për pasjen e jetës më të mirë të mundshme.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë agjendë kanë kryesisht natyrë ndërsektoriale për të adresuar nevojat për parandalim, mbrojtje, ndërhyrje afatgjata, ofrimin e shërbimeve miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve dhe promovimin e të drejtave duke adresuar normat sociale. Natyra e objektivave dhe e ndërhyrjeve është njëkohësisht holistike, duke synuar një impakt më të madh në jetën e fëmijëve.

Objektivat dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve janë hartuar në përputhje me Dokumentin e politikave “E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri. Vizioni i saj është të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Agjenda është dokumenti i parë politik i cili është konsultuar me fëmijët. Ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me organizatën Eorld Vision organizuan në nëntor 2016 konsultimin e draft AKDF-së me fëmijët.

Zbatimi i AKDF do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me asistencën e Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për procesin e mbledhjes së të dhënave, në kuadrin e monitorimit dhe raportimit të progresit.

### 1.3 Aktet nënligjore të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Ligji i ri 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” krijon detyrimin për miratimin e akteve nënligjore. Me Urdhërin Nr.407, datë 11.10.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj.Ogerta Manastirliu u ngrit grupi institucional i punës për hartimin e akteve nënligjore të ligjit 18/2017, më përfaqësues nga MSHMS dhe ASHDMF. Gjithashtu procesi i hartimit të propozimeve për secilin nga aktet nënligjore të kërkuara në ligj po zhvillohet dhe me mbështetjen e 4 partnerëve kryesorë: UNICEF Albania / TLAS, Terre des Hommes, Save the Children dhe prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Aktualisht janë miratuar 6 Vendime të Këshillit të Ministrave:

1. VKM Nr. 54, dt. 31.01.2018 “Për Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen”;
2. VKM Nr. 91, dt. 14.02.2018 “Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
3. VKM Nr.148, datë 13.03.2018 “Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmave Këshillimorë e Koordinues Institucionalë, Strukturave për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Organizatave Jofitimprurëse, për Realizimin e Politikave Kombëtare e Vendore si dhe për shërbimet e Nevojshme për Mbrojtjen e Fëmijës”.
4. VKM Nr. 353, dt.12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”
5. VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
6. V.K.M Nr. 565, datë 29.9.2018 “Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Aktualisht janë në proces draftimi edhe aktet e tjera nënligjore të parashikuara në ligj. Projektvendimet janë konsultuar me shoqërinë civile, përfaqësues të institucioneve, profesionistët në nivel vendor si dhe ministritë e linjës.

## **KAPITULLI II - KUADRI INSTITUCIONAL**

Në Ligjin 18/2017 përcakton se cilat janë mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionale dhe strukturat për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror dhe vendor, detyrat, përgjegjësitë ligjore dhe mënyrën e bashkëveprimit të tyre për të siguruar realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Sipas ligjit mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:

- a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;
- b) Grupi Teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.

Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:

- a) Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
- b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- c) Çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

- a) bashkia;
- b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësie administrative;
- d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

## 2.1 Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë

**Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës** është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

Në datën 1 mars 2018 u realizua mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pas miratimit të ligjit të ri 18/2017. Bazuar në VKM Nr.54, datë 31.01.2018 “Për Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, mbledhja e parë e Këshillit realizohet pa pjesëmarrjen e anëtarëve të shoqërisë civile. Në mbledhjen e parë të Këshillit u miratua i Udhëzimit i cili përcakton kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, të cilët do të jenë anëtarë të KKDMF. Pas miratimit Udhëzimi i’u dërgua për zbatim Këshillit Kombëtar të Shoqërive Civile.

**Grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative (GTN).** Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet *ad-hoc*, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje. GTN ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial. GTN mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

## 2.2 Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe vendor

**Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës** është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimit e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e ligjit 18/2017, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, përgatit raportet përkatëse, kontrollon punën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës.

**Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës** është institucion në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës i cili ka për qëllim koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. ASHDMF ka për detyrë t'u afrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor lidhur me asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, zhvillimin e aktiviteteve profesionale në lidhje me mbrojtjen e fëmijës. Gjithashtu sipas ligjit të ri, ASHDMF ka të drejtë të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes së fëmijës si dhe të analizojë nevojën për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi.

**Ministrat**, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë të sigurojnë zbatimin e plotë të ligjit 18/2017 dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës. Të hartojnë politika sektoriale, akte ligjore dhe nënligjore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke i shoqëruar me një analizë të ndikimit që do të kenë këto akte tek fëmijët. Gjithashtu ministrat duhet të parashikojnë në planet e tyre vjetore ose shumë vjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave dhe për mbrojtjen e fëmijës.

**Bashkitë** janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në

varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen e programeve dhe shërbimeve rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, parashikimin në buxhetet e tyre , të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës si dhe financimin e shpenzimeve për zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës dhe planit për aftësimin prindëror. Bashkitë kanë detyrimin për zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që venë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik dhe emocional.

**Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë** është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij. Ligji i ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës i jep një sërë detyrash të rëndësishme drejtorit të kësaj Strukture.

**Drejtori i Strukturës përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore në Bashki** është përgjegjës për marrjen e vendimit për masën e mbrojtjes për fëmijët në nevojë për mbrojtje, bazuar në propozimin e PMF dhe GTN. Marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtje emergjent 24-orësh, miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e planit individual të mbrojtjes si dhe marrjen e masave për financimin e shpenzimeve të këtij plani.

**Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve** ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Ligji 18/2017 paraqet detyrimin e ngritjes së Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës, në çdo bashki dhe njësi administrative me standardin, të paktën një Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës për çdo 3000 fëmijë. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë të mbështesë PMF në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkisë , për të cilën është marrë masë mbrojtje dhe/ose është hartuar plani individual i mbrojtjes.

**Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës** në njësitë administrative të bashkive janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit dhe zbatimit të masës së mbrojtjes deri në përfundimin e tyre. Ai ka për detyrë të identifikojë në mënyrë proactive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave në terren dhe në familjen e fëmijës



në rrezik, komunikimit me profesionistët të cilët kanë kontakte me fëmijët, të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut për fëmijët e identifikuar, të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial si dhe të hartojë planin individual të mbrojtjes.

## KAPITULLI IV- TË DHËNA SHIFRORE MBI RASTET E FËMIJËVE NË RREZIK

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” institucionalizon Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës si struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Ky kapitull përmban informacion mbi të dhënat statistikore të rasteve të menaxhuara të fëmijëve në rrezik nga NJMF-të për vitin 2017. Ai jep një panoramë të qartë të punës së NJMF.

Bazuar në VKM Nr. **267, datë 12.4.2012** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, NJMF-të, raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi.

Formulari i Raportimit Periodik për NJMF-të përbëhet nga dy pjesë :

- **Formulari A** lidhet me kërkesën për raportim për të dhëna statistikore të rasteve të menaxhuarat fëmijëve;
- **Formulari B** lidhet me kërkesën për informacion mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve të reja, vizitave ne familje, trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.


Ky kapitull, gjithashtu jep të dhëna në shifra në lidhje me numrin e rasteve të fëmijëve që janë menaxhuar nga PMF për vitin 2017. Këto raste disagregohen sipas katër niveleve të rrezikut, moshës, gjinisë dhe etnisë, aktorëve apo institucioneve që kanë identifikuar apo referuar rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Së fundmi, kapitulli përmban informacion në shifra lidhur me rastet e mbyllura.

### 4.1 PMF dhe raportimi ndër vite

Aktualisht, në vitin 2017 rezulton se në total janë 223 punonjës të mbrojtjes së fëmijës, nga të cilët 133 kanë raportuar pranë ASHMDF. Krahasuar me vitin 2016 vihet re një rritje e numrit të punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe ulje e numrit të PMF të cilët kanë raportuar.

Tabela e mëposhtme jep një vështrim krahasues ndër vite, lidhur me numrin e PMF në territorin e vendit tonë dhe numrin e PMF të cilat kanë raportuar pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

**Tabela: PMF dhe Raportimi i PMF-ve në vite**



Në lidhje me cilësinë e raportimit vihet re se plotësimi i formularit A për vitin 2017 ka paraqitur po të njëjtat vështirësi për NJMF-të krahasuar me vitin 2016. Ndodh të raportohen shifra të pa rakorduara sipas indikatorëve apo raportime të pjesshme si dhe për disa indikatorë ka vështirësi në kuptueshmërinë dhe në plotësimin e tyre.

Në ligjin e ri për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është propozuar që NJMF-të i raportojnë periodikisht, ASHDMF të dhënat statistikore që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse. Gjithashtu në zbatim të këtij ligji është parashikuar të dalë edhe një VKM për mbledhjen e të dhënave statistikore në nivel qendror dhe vendor mbi çështjet e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve.

#### 4.2 Profili dhe roli i PMF-ve

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka mbledhur informacion përmes shkresave të raportimit periodik si dhe përmes komunikimit me telefon me NJMF-të, informacion në lidhje me rolin si NJMF dhe profilin e Punonjësit Social. Nga informacioni i mbledhur rezultoi se vetëm 45 punonjës kryejnë funksionin si PMF, ndërsa pjesa tjetër 118 përveç detyrës si PMF kryejnë edhe detyra të tjera.

	Viti 2016				Viti 2017			
	PO	JO	S'ka informacion	TOTALI	PO	JO	S'ka informacion	TOTALI
Vetëm PMF	41 (19%)	110	70	221	45(20%)	118	60	223
Punonjës Social	67 (30%)	88	66	<b>221</b>	78(35%)	86	59	223

Në ligjin e ri nr. 18/2017, në nenin 49 është e përcaktuar qartë se Punonjësit e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë. Nga të dhënat e raportuara rezulton se vetëm 35% e numrit total të PMF-ve janë punonjës social.

Në njësitë administrative dhe sidomos ato në zona të thella, mund të jetë e vështirë të identifikosh një person lokal që ka kualifikimet / përvojën e nevojshme. Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara në mënyrë të përshtatshme, sjell një kufizim të veçantë të ofrimit të shërbimeve nga ana e PMF-ve si edhe cilësisë së menaxhimit të rasteve.

Sipas ligjit të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” çdo njësi administrative e bashkisë e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Bazuar në standardin që ngre ligji 18/2017, por edhe në numrin e rasteve të raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të menaxhuara nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, nevojiten 170 punonjës që kryejnë detyrën vetëm si PMF dhe 251 punonjës që jo detyrimisht duhet të jenë vetëm PMF, pra në total nevojiten minimalisht 421 punonjës të mbrojtjes së fëmijës në të gjithë territorin.


#### 4.3 Numri i PMF sipas numrit të rasteve të raportuara

Për vitin 2017 nga 133 PMF të cilët kanë raportuar pranë ASHMDF, rezulton se 56 prej tyre kanë raportuar 0 raste të ndjekura dhe 77 PMF kanë raportuar të paktën një rast. Krahasuar me vitin 2016 vihet re një ulje e numrit të PMF të cilat kanë raportuar 0 raste dhe një ulje e numrit të PMF të cilat kanë raportuar të paktën një rast.

Këto shifra tregojnë se ka akoma punë për t'u bërë nga ana NJMF-ve në identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për mbrojtje por edhe në rritjen e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse.

Nga raportimet vihet re se punonjësi i mbrojtjes së fëmijës që ka menaxhuar më shumë raste vazhdon të jetë PMF në bashkinë Elbasan me 161 raste të menaxhuara, më pas vjen PMF e bashkisë Fier me 120 raste, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë me 106 raste dhe Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, me 72 raste të menaxhuara.


**Tabela: Numri i PMF sipas numrit të rasteve të raportuara**



#### 4.4 Raste të menaxhuara në total nga PMF

Gjatë vitit 2017, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës kanë menaxhuar në total rreth 1650 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga të cilat 929 janë raste të reja të menaxhuara nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe pjesa tjetër, janë raste të identifikuar gjatë viteve të mëparshme (raste të mbartura), të cilat janë ende në menaxhim. Nga tabela më poshtme vihet re një rritje e numrit të rasteve të menaxhuara nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijës


**Tabela: Raste të menaxhuara ndër vite**



#### 4.5 Rastet e reja të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë

Ky seksion bën një analizë të rasteve të reja të disagreguara sipas moshës, gjinisë dhe etnisë. Nëse krahasojmë të dhënat e vitit 2016 me të dhënat e vitit 2017, vihet re se për vitin 2016 femrat janë pak më shumë në numër në krahasim me meshkujt ndërsa në vitin 2017 meshkujt janë më të shumtë në numër krahasuar më femrat. Nga 929 raste të reja të identifikuar rreth 49% janë femra dhe 51% meshkuj.

Nga 929 raste të reja të identifikuar, konstatojmë se 256 raste të menaxhuara i takojnë komunitetit rom, 229 egjiptianë, 1 të tjerë dhe 443 raste janë popullsi maxhoritare (shqiptarë).



Referuar numrit të rasteve të reja të identifikuara, 195 raste i përkasin grupmoshës 0-3 vjeç, 167 raste i përkasin grupmoshës 4-6 vjeç, 172 raste janë të grupmoshës 7-9 vjeç, 173 raste grupmosha 10-12 vjeç, 132 raste grupmosha 13- 15 vjeç dhe 90 raste grupmosha 16-18 vjeç.

<b>Grupmosha</b>	0-3 vjeç	4-6 vjeç	7-9 vjeç	10-12 vjeç	13- 15 vjeç	16-18 vjeç
Viti 2017	<b>195</b>	<b>167</b>	<b>172</b>	<b>173</b>	<b>132</b>	<b>90</b>
Numri i rasteve	<b>66.7%</b>	<b>17.9%</b>	<b>18.5%</b>	<b>17.4%</b>	<b>14.2%</b>	<b>9.7%</b>

Siç shihet nga tabela e mësipërme përqindjen më të madhe të rasteve të reja të identifikuara e zënë fëmijët e grupmoshës 0-3 vjeç.

#### 4.6 Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve

Detyrimi për raportim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshi ata në rrezik, parashikohet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët pavarësisht përcaktimeve ligjore, të cilat ndodhen për disa kategori në akte të tjera ligjore. Parashikimi në ligjin 18/2017 i detyrimit për raportim, vjen me detajimin se ku duhet të raportojnë punonjësit që punojnë me fëmijët, duke përfshirë përveç strukturave hierarkike institucionale edhe raportimin tek strukturat e mbrojtjes së Fëmijës.


NJMF-të raportojnë pranë Agjencisë rastet e identifikuara/ referuara të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzim ndaj fëmijëve qoftë nga vetë ata si punonjës të NJMF, si persona përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe nga aktorë publikë dhe jo publikë apo dhe struktura të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me NJMF.

Nga tabela e mëposhtme, për vitin 2017 konstatohet një rritje e numrit total të raportimeve krahasuar me vitin 2016. Vihet re një ulje e numrit të referimeve nga administratorët e ndihmës ekonomike dhe një rritje e numrit të referimeve nga institucionet shëndetësore krahasuar me vitin 2016.

Për vitin 2017 numri më i madh i rasteve është identifikuar nga vetë NJMF-të. Numri më i madh i rasteve në dy vitet e fundit është identifikuar nga vetë NJMF-të: 35.2% raste për vitin 2017 dhe 37 % raste për vitin 2016.


Gjithashtu konstatohet një rritje e numrit të raportimeve të ardhura nga vetë fëmijët çka do të thotë që edhe vete fëmijët janë ndërgjegjësuar dhe sensibilizuar për të raportuar rastet e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit.

**Tabela: Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve**



#### 4.7 Raste të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut

**Tabela: Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut**




Për vitin 2017 rezulton që nga njësitë e mbrojtjes së fëmijës janë menaxhuar në total 1650 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Nga raportimet rezulton se në përgjithësi NJMF-të trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Bazuar në raportimet e NJMF-ve për vitin 2017, numri më i madh i rasteve kanë qenë raste me nivel të mesëm rrezikshmërie, 689 raste ose 42 % e rasteve të menaxhuara në total. Vihet re një rritje e lehtë e numrit të rasteve emergjente të trajtuara nga PMF, në vitin 2016 kemi 57 raste emergjente të trajtuara, ndërkohë për vitin 2017 kemi 78 raste.

## 4.8 Rastet e mbyllura

Gjatë vitit 2017, janë mbyllur 498 raste, që shënon një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2016 (442 raste të mbyllura). Për të dyja vitet numri i rasteve të reja të identifikuar është më i madh se rastet e mbyllura. Kjo nënkupton se një numër i madh rastesh, mbarten ose vazhdojnë të menaxhohen në vitin në vazhdim. Vihet re se një numër i konsiderueshëm i rasteve është mbyllur si rezultat i reduktimit të nivelit të rrezikut çka do të thotë një rritje e kuptueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisive ligjore. Kjo e dhënë pozitive, tregon se janë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhet fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut.

**Tabela : Numri i rasteve të mbyllura sipas arsyes**



## KAPITULLI V - PROBLEMATIKAT, NATYRA E RREZIKUT DHE LLOJET E ABUZIMIT

Informacioni që mblidhet nga Formularit B<sup>3</sup> përmban të dhëna mbi menaxhimin e rasteve të reja për vitin 2016, problematikat e trajtuara, natyrën e rrezikut dhe llojet e abuzimit ndaj fëmijëve. Menaxhimi i rastit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si dhe Udhëzimit 4 ministror Nr.10, datë 25.2.2015<sup>4</sup> duke përfshirë shërbimet dhe ndërhyrjet ofruara, bazuar në problematikën e identifikuar dhe nevojat e rastit. Formulari B për herë të parë këtë vit kërkoi të dhëna për rastet e mbartura nga periudhat e mëparshme që vazhdojnë të menaxhohen. Kjo erdhi si rekomandim nga raporti i vitit të kaluar.

<sup>3</sup> Aneks 2


<sup>4</sup> Udhëzimi Nr.10, datë 25.2.2015<sup>4</sup>



## 5.1 Problematikat e rasteve të menaxhuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve

Tabela më poshtë përmban të dhënat e raportuara nga NJMF-të lidhur me problematikën kryesore që ka secili rast i fëmijëve të menaxhuar, duke bërë edhe krahasimin me të dhënat e vitit 2016.

**Tabela :Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje, sipas problematikave**



Nga krahasimi me 2016 vërehet se numri total i rasteve të menaxhuara është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Edhe për vitin 2017 **problemet ekonomike** janë problematika kryesore e fëmijëve të marrë në mbrojtje nga NJMF-të

672 raste janë trajtuar për vitin 2017 krahasuar me 588 raste të tilla janë trajtuar për vitin 2016.

Ka shënuar rritje krahasuar me vitin e kaluar. Shpesh problemet ekonomike janë të shoqëruara me të tjera problematika, si vështirësi për regjistrim në gjendjen civile, përkujdes prindëror, përkujdes shëndetësor.

Nga informacionet e dhe nga kontaktet e përditshme me NJMF-të rezulton që është shtuar puna proaktive e NJMF-ve të cilat kanë arritur të identifikojnë më shumë raste fëmijësh të cilët janë në vështirësi ekonomike dhe janë menaxhuar si raste duke ndihmuar familjet e tyre për të dalë nga situata e varfërisë ekonomike.

Raportohet që vetë fëmijët janë aktivë në referimin e rasteve . Në ndihmë u ka ardhur linja e këshillimit Alo 116111. Aty fëmijët referojnë rastet e dhunës, abuzimit por dhe nevojat ekonomike që kanë familjet e tyre. Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit Nr 103/1 Prot datë 21.04.2016, midis ASHDMF dhe Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë (ALO 116) e cila ka si objektiv përmirësimin e sistemit të referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik,përmes rritjes së

bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkërendimit të punës ndërmjet strukturave publike, për vitin 2017 janë referuar nga ALO pranë NJMF – ve, 42 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Për këto raste Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë (ALO 116 111) ka vënë në dijeni dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

*Vajza banon në fshatin Çerçan të Njësisë Administrative Hotolisht në një familje prej 5 anëtarësh. Familja jeton në një banesë (barake). Vajza 14 vjeçare ka telefonuar tek NJMF për të treguar gjendjen e vështirë ekonomike dhe kushtet ku ajo jeton. NJMF-ja ka bërë vizitën në shtëpi dhe vlerësimin e gjendjes. Menjëherë ka filluar trajtimi i familjes me ndihma ushqimore dhe materiale të ardhura nga Bashkia, shoqata të ndryshme .Konkretisht Bashkia Librazhd ka dhënë një fond prej 2 milion lekësh për rastin, Njësia Administrative Hotolisht ,Ëorld Vizion vazhdojnë koordinimet për rregullimin e një banese të përshtatshme **Qendër , Librazhd**<sup>5</sup>*

Familjet me probleme ekonomike janë suportuar nga NJMF-të por me qëllim të përmirësimit të situatës në nivel afatgjatë duke i referuar prindërit e papunë për punësim te zyrat e punës. Rastet e familjeve me probleme ekonomike raportohen në shumicën e rasteve si raste të mbartura të cilat kërkojnë monitorim në vazhdimësi nga NJMF-të.

*Babai i fëmijëve ndërron jetë. Nëna ka shumë vështirësi dhe probleme ekonomike në rritjen e fëmijëve. Familja ka nevojë për mbështetje në plotësimin e nevojave bazë, mbështetje psiko-sociale për fëmijët. Nëna e fëmijëve edhe pse me problemeve shëndetësore, kërkon punë pasi ndodhet në vështirësi ekonomike. Të tre fëmijët janë mirë nga gjendja shëndetësore dhe janë me rezultate të mira në mësim. **Tiranë***

Për nga numri listohet si problematika e dytë në radhë ajo e **shfrytëzimit ekonomik** të fëmijëve. Në vitin 2016 kanë qenë 318 fëmijë të shfrytëzuar ekonomikisht dhe në shifra të përafërta, por në rritje janë gjithashtu të dhënat për vitin 2017 që shënojnë 387 raste fëmijësh. Në periudhën e stinës së verës puna për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve është intensifikuar duke rritur dhe numrin e rasteve të trajtuara.

Problematika e **dhunës në familje** është problematika e tretë për nga numri i rasteve. Evidente është që kjo shifër është pothuajse e dyfishuar për vitin 2017. Nëse në tre vitet paraardhëse shifrat e rasteve të dhunës kanë qenë në rezultate të përafërta, dyfishimi në 2017 tregon që dhuna ndaj fëmijëve raportohet dhe nuk rri e fshehur brenda mureve të shtëpisë. Kjo është gjithashtu rritje e besimit ndaj institucioneve përveçse mund të jenë rritur, së paku ato raportohen në një numër më të madh rastesh. Rastet e dhunës në familje përfshijnë dhunë psikologjike dhe fizike ndaj fëmijës.

<sup>5</sup> Rastet janë pasqyruar ashtu sikurse kanë raportuar NJMF-të

*Rasti u referua nga policia gjatë muajit nëntor. Familja ka dy fëmijë të moshës 8 dhe 5 vjeç të cilët kanë qenë dëshmitarë të dhunës së ushtruar në familje nga babai ndaj nënës. Gjatë viteve të fundit ata kanë jetuar si dëshmitarë të kësaj dhune. Pasi u bë vlerësimi fillestar u mbledh grupi teknik. Nëna mori Urdhër Mbrojtje nga gjykata, fëmijët marrin shërbimin psikologjik në shkollë. Fëmijët jetojnë me nënën në shtëpinë e prindërve të saj. Babai i fëmijëve është ndaluar me arrest. **Kuçovë***

Ndodh që dhuna ushtrohet ndaj anëtarëve të tjerë të familjes si nëna, vëllai apo motra gjithashtu përjetohet si dhunë nga fëmijët. Ka raste kur dhuna ushtrohet dhe nga anëtarë të familjes së madhe ndaj nënës dhe fëmijëve, (vjehera ) apo dhe raste të djalit ndaj nënës dhe fëmijëve .

*PMF Nr.4 mori referim nga shkolla se dy vajzat K dhe L pasi kanë dy javë që nuk frekuentojnë shkollën, pasi babai i tyre nuk i lejon edhe pse mësuesja kujdestare ka shkuar në shtëpi për të komunikuar me babin për ta bindur që të rikthej përsëri në shkollë vajzat. Mësuesja referoi që babai ishte agresiv dhe gjatë vizitës në shtëpi kishte mbyllur derën me forca dhe nuk pranoi të bisedonte me të. **Tiranë***

Rastet kur prindërit janë të ndarë apo në proces divorci, kanë konflikte reflektohen në dhune tek fëmijët, kryesisht dhunë psikologjike. Rastet e dhunës ndaj nënave nga baballarët rezultojnë me pasoja psikologjike tek fëmijët. NJMF-të kanë asistuar raste të zbatimit të vendimeve të gjykatës për kthimin e fëmijëve tek nëna si dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike nëpërmjet takimeve individuale me fëmijët.

*Rast dhune fizike mbi nënën e fëmijëve dhe nxjerrje me forcë nga shtëpia e nënës dhe tre fëmijëve nga vjehera. Nëna bashkë me tre fëmijët jetonin në shtëpinë e prindërve të bashkëshortit ndërkohë që ky i fundit me lindjen e fëmijës së tretë e ka braktisur familjen. **Shushicë***

**Braktisja shkollore** për vitin 2017 shënon një ulje krahasuar me vitin e kaluar, nga 96 raste në 2016 janë ulur në 80 raste në vitin 2017. Ky tregues i përmirësuar lidhet me punën e cila në tre vitet e fundit është intensifikuar nga NJMF-të në bashkëpunim me DAR/ZA për regjistrimin në shkollë të gjithë fëmijëve të identifikuar dhe frekuentimin më pas të saj. Prej tre vitesh ASHDMF ka nxitur NJMF-të dhe ka kërkuar informacion për frekuentimin e shkollës të fëmijëve në rrezik braktisje të regjistruar në shkollë.

Raportohen pothuajse në shifra të përafërta me 2016 problematikat e tjera si **trafikimi** dhe **aftësia e kufizuar**. Një ulje e lehtë kanë shënuar rastet e trafikimi nga 17 në 15 për vitin 2017. Rastet e

fëmijëve në situatë rruge për të cilët ka pasur dyshime se janë në rrezik trafikimi agjencia i ka ndjekur në mënyrë të veçantë dhe ka koordinuar institucionet për trajtimin e këtyre rasteve.<sup>6</sup>

**Fëmijët me aftësi të kufizuar** gjithnjë e më tepër janë në fokus të punës për NJMF-të. Riaftësimi dhe integrimi i tyre në shkolla dhe aktivitete të tjera është në fokus të punës së NJMF-ve. Puna e NJMF nuk është mjaftuar vetëm në orientimin e prindërve për sigurimin e pagesës së paaftësisë për fëmijët, por me tepër drejt sigurimit të aksesit në shërbime dhe ndjekjes së arsimit të detyrueshëm për këta fëmijë. Për fëmijët që kanë diagnoza të veçanta dhe kanë nevojë për trajtim marrin trajtim 29 në qendra të specializuara.

Nga puna për fëmijët në situatë rruge janë identifikuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuar që shfrytëzohen për lypje në rruge, sidomos në bashkinë Tiranë. Këto raste janë marrë në mbrojtje të menjëhershme dhe aktualisht këta fëmijë marrin shërbim të specializuar në qendra të specializuara.

Nevoja për mësues mbështetës mbetet një sfidë në vijim për trajtimin dhe sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me Aftësi të Kufizuar që ndjekin shkollën.

### **Regjistrimi i fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile**

Për vitin 2017 janë trajtuar 51 raste.. Rastet e fëmijëve të paregjistruar në të shumtën e tyre janë raste që kanë lindur jashtë vendit dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe pamundësisë ekonomike të familjeve për të ndjekur procedurat dhe paguar tarifat nuk arrijnë të regjistrojnë fëmijët në gjendje civile. Shpesh prindërit kanë dhe mungesë informacioni mbi rrugën ligjore që duhet ndjekur për këto raste. NJMF-të të cilat kanë informacionin e duhur mbi udhëzimet e Ministrisë së Brendshme për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar, kanë mbështetur familjet dhe shpesh i shoqërojnë vetë ato në zyrat e gjendjes civile për regjistrim të tyre. Për rastet e ndërlikuara, ku kërkohen procedura dhe pagesat janë të papërballeshme për familjet, apo sigurimi i dokumentacionit duhet bërë në shtete të tjera, nga NJMF- të është kërkuar bashkëpunimi i organizatave që kanë ekspertizë në këtë fushë dhe mund të mbështesin NJMF-të me shpenzime financiare sipas rastit.

*F.Q 3 vjeç nga komuniteti egjiptian është i paregjistruar në gjendjen civile. Fëmija ka lindur në Gjermani dhe vëstitrësi për regjistrimin e tij qëndron se për sigurimin e dokumentacionit mungon pulla Apostile. **Tiranë***

*Pas vdekjes së nënës dhe arrestimit të babait, fëmijët jetojnë me xhaxhain, hallën, gjyshin, gjyshen në një shtëpi me qira. Problemi kryesor është regjistrimi i dy fëmijëve të vegjël që kanë lindur në Greqi të cilët nuk janë të regjistruar në gjendje civile. Lidhur me këtë është bashkëpunuar me TLAS për sigurimin e dokumentacionit . **Librazhd.***

<sup>6</sup> Per keto raste do të jepet më tepër informacion në kapitullin e veçantë për fëmijët në situatë rruge.

Gama e problematikave që trajtohen nga NJMF-të është rritur. P.sh. një problematikë më pak e raportuar më përpara është ajo e fëmijëve me probleme të sjelljes ose që janë përfshirë në vepra penale si vjedhje apo kultivim të lëndëve narkotike. Këto raste kryesisht referohen nga shkollat, por dhe nga familjarë të fëmijëve. Kjo shton dhe rritjen e përgjegjësisë, por dhe sfida për punën e NJMF-te, të cilat duhet të bashkëpunojnë me aktore të tjerë nga arsimi, shëndetësia, policia, shkolla për detyrimin e NJMF-ve për të bashkëpunuar me aktorët për rritjen e shërbimeve cilësore për raste specifike që kërkojnë dhe ndërhyrje specifike dhe afatgjatë.

*Pasi ka kryer dënimin në Instituti i të Miturve në Kavajë me akuzën vjedhje me dhunë, në fillim ka qenë e vështirë vendosja e marrëdhënies së besimit me PMF. E. donte të largohej, nuk ishte bashkëpunues dhe nuk pranonte të jepte informacione. Gjithsesi pas përpjekjeve E. u tregua i gatshëm të përfshihej në programe trajnimi dhe punësimi. **Daj***

Përveç problematikave të sipërpërmendura ka dhe raste që trajtohen për më shumë se një problematikë. Janë raste e fëmijëve nga familje të varfra që janë më vulnerabël ndaj formave të ndryshme të rrezikut dhe problematikat shfaqen komplekse dhe të kombinuara me njëra tjetrën tjera duke thelluar njëkohësisht edhe impaktin e tyre tek fëmija dhe familja.

## 5.2 Abuzimi


Ekzistojnë 4 lloje e abuzimit të klasifikuara sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë Abuzimi fizik; Abuzimi seksual; Abuzimi psikologjik; Neglizhimi.

NJMF-të raportojnë për 4 llojet e abuzimit të sipërpërmendura. Sipas nenit 62 të Ligjit nr. 18/2017 strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar, duke ofruar mbrojtjen e nevojshme për çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar. Ligji i ri i trajton rastet e abuzimit si kategori që kërkojnë mbrojtje të posaçme.

**Bazuar në të dhënat e grafikut të mëposhtëm** nga 1650 raste të ndjekura në total nga NJMF-të gjatë vitit 2017, **1201** raste, kanë qenë fëmijë të cilët kanë pësuar të paktën një nga llojet e abuzimit,

Në total rezulton një rritje e rasteve të trajtuara të abuzimit që përbëjnë rreth 73% të totalit të rasteve të trajtuara.

**Grafiku: Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas llojit të abuzimit**



Edhe për vitin 2017 vendin e parë të rasteve të abuzimit e zënë rastet e **neglizhimit** me 683 raste, ose 57 % e rasteve të trajtuara. Të dhënat dy viteve të fundit tregojnë për dyfishim të shifrave të neglizhimit. Edhe për vitin 2017 ka pasur një trend rritje të raportuar të abuzimit. Më së shumti këto raste janë identifikuar në bashkitë Shkodër, Fier, Poliçan. Tiranë. Por dhe në bashkitë tjera raportohet ky abuzim i cili shpesh është i kombinuar me llojet e tjera të abuzimit.

*Gjatë vizitave në familje janë fëmijë të cilët janë neglizhuar nga prindërit e tyre, pasi rezultojnë se kanë braktisur shkollën dhe prindërit nuk kanë marrë masa për t'i kthyer ata në shkollë.*  
**Fushë-Krujë**

*Fëmija është i neglizhuar nga babai dhe njerka e tij. Gjatë vizitës në familje është mbajtur një procesverbal ku babai dhe njerka e tij kanë pranuar që të kujdesen për djalin. Nga vizitat e tjera në vijim rezulton që sërish djali nuk ka përkujdesjen nga familja e tij. Pas kësaj kam mbledhur dy herë grupin multidisipinar për të të marrë në mbrojtje fëmijën.*  
**Belsh**

Mungesa e vaksinimit ose kequshqyerja është tregues neglizhimi. Rastet e raportuara nga NJMF-të për neglizhimin lidhen me mungesën e kujdesit për ushqim, vëmendje, siguri, strehë. Zakonisht fëmijët e neglizhuar janë nga familje të varfra, por jo vetëm. Ka dhe raste kur nëna vuan nga probleme të shëndetit mendor dhe nuk ka aftësinë për t'u kujdesur për mirëushqyerjen e fëmijës. Shpesh rastet e neglizhimit raportohen si të mbartura dhe ndiqen në vazhdimësi nga NJM-të, pasi prindërit, kryesisht nënat kanë nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme lidhur me kujdesin ndaj fëmijëve të tyre.

*Rasti është referuar tek NJMF nga spitali Korçë për një fëmijë 3 vjeç, pasi nëna ishte e ndarë nga bashkëshorti dhe jetonte tek shtëpia e prindërve të saj në një fshat shumë larg qytetit. Fëmija është dërguar në Spitalin e Tiranës, por nëna nuk e ka shoqëruar fëmijën sepse nuk ka gjendje kritike për jetën, për shkak të kequshqyerjes dhe kishte një peshë vetëm 5 kg. Nëna vuan nga një sëmundje e lehtë e mendor. **Korçë***

NJMF-të kanë menaxhuar rastet duke shoqëruar prindërit në spital për vizita për fëmijën, vizita në familje dhe mbikëqyrje e vazhdueshme për mirëushqyerjen e fëmijëve. Janë këshilluar nënat për mënyrën e ushqyerjes së fëmijëve si edhe janë monitoruar vazhdimisht. Në këto raste është kërkuar dhe bashkëpunimi me organizatat të cilat kanë dhënë dhe mbështetje në ekspertizë si dhe mbështetje financiare për familjet dhe nënat.

**Abuzimi psikologjik** për vitin 2017 mbetet sërish nga format më të raportuara në total ( 24 % e rasteve) duke shënuar një rritje të lehtë nga viti i kaluar që ishte 21 % e rasteve. Raportimi i këtij lloji abuzimi në rritje është për t'u vlerësuar, pasi shpesh më përpara neglizhohej si formë abuzimi edhe pse është me pasoja të rënda për fëmijët. Pasojat e tij mund të çojnë në sjellje degraduese, frikësuese, refuzuese të fëmijës. Abuzimet zakonisht kryhen nga të afërm të familjes, por persona të tjerë që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijën. Abuzimi psikologjik ndodh në familje, por dhe në shkolla, ndodh në ambientet që frekuentojnë fëmijët. Prindër të alkoolizuar dhe të dhunshëm në familje përbëjnë një nga shkaqet e raportuar të abuzimit psikologjik.

*Vajza e cila është e moshës 6 vjeç, jetonte vetëm me babanë. Babai ishte njeri me probleme të sjelljes dhe konsumonte shpesh alkool. NJMF është njoftuar nga shkolla që vajza dhunohej psikologjikisht nga babai. **Divjakë***

Shpesh problematika e këtij abuzimi lidhet dhe me paragjykimet që kanë prindërit për dhe njohjet dhe lidhjet mes të rinjve dhe fazat e zhvillimit që kalojnë fëmijët. Për shkak të mentalitetit , sidomos për vajzat në zona rurale është e papranueshme që vajzat të krijojnë njohje me moshatarë ose me djem më të rritur.

*M është banues në Krujë. Me datë 24.06.2017 familja e R.M ka bërë një kallëzim në komisariatit e policisë për largimin e vajzës së tyre. **Thumanë***

*R. ndiqte kursin e anglishtes në qytetin e Laçit, nga ku është larguar. Është gjetur në mesditë në Shëngjin nga policia e Kurbinit së bashku me shokun e saj. Vajza nuk dëshironte të kthehej në shtëpi pasi pretendonte se ishte fejuar në moshë të vogël dhe familja e saj do ta martonte tani në gusht. Përveç kësaj ajo pretendonte të ishte dhunuar psikologjikisht në familje. **Kurbin***

Rastet e **abuzimit fizik** të trajtuara nga NJMF-të zënë rreth 16 % e rasteve në total dhe kanë pësuar rritje për vitin 2017 krahasuar me 11% të rasteve në vitin 2016.

Edhe në rastet e abuzimit fizik, raportohet se abuzues është babai, por ka dhe raste kur është nëna e fëmijës. Në rastet e dhunës së babait ndaj nënës dhe ndaj fëmijëve abuzimi fizik shkon bashkë me atë psikologjik. Rastet janë referuar kryesisht nga policia dhe në bashkëpunim me aktorët e tjerë, NJMF-të raportojnë që në këto raste është kërkuar Urdhër Mbrojtje për nënën dhe fëmijën, nënat janë mbështetur financiarisht , janë futur në skemën e ndihmës ekonomike, janë mbështetur psikologjikisht nëna dhe fëmijë sipas vlerësimit dhe nevojës.

*Fëmija është abuzuar fizikisht nga babai. Familja e fëmijës është në kushte të vështira ekonomike. Babai ushtron dhunë ndaj nënës dhe ndaj fëmijës. Është mbajtur takim multidisiplinar për rastin. **Gramsh***

*Babai ka ushtruar dhunë ndaj nënës dhe fëmijës, prindërit janë të divorcuar. Nëna është person me nevoja te veçanta. Të dy, nëna me fëmijën jetojnë te shtëpia e vëllait të saj. Daja i fëmijës është i detyruar të kujdeset për fëmijën . **Kuçovë***

**Rastet e abuzimit seksual ndaj fëmijëve** për vitin 2017 ka një rritje të numrit të përgjithshëm të raportuar gjithsej 39 raste, krahasuar me 27 raste në 2016. Por që mbeten në të njëjtat përqindje si në vitin 2016 dhe zënë rreth **3 %** të rasteve në total. Raste më të shumta janë raportuar në Tiranë dhe Durrës por ka pasur dhe raste në bashkitë Vlorë Berat , Kuçovë.

Rastet e abuzimit seksual, lidhen me ngacmime apo abuzime të fëmijëve nga persona të afërm në familje, si babai, xhaxhai ose gjyshi, por dhe persona të panjohur. Ka pasur raste kur abuzimi është kryer mes fëmijëve më të rritur ndaj një fëmijë tjetër më të vogël.

Për këto raste reagimi i strukturave është i menjëhershme. Strukturat e policisë kanë referuar rastet e tek NJMF, e cila ka siguruar mbështetja e psikologut të specializuar. Është punuar jo vetëm me fëmijët, por dhe me familjen e cila jo në të gjitha rastet ka aftësinë të përballojë traumën dhe të mbështesë fëmijën. Ka pasur raste kur prindi “fajëson “fëmijën për abuzimin e ndodhur , dhe në këto raste NJMF-ja ka ndërhyrë në familje për përmirësimin e marrëdhënieve



prind-fëmijë. Puna e psikologut për këto raste ka qenë e vështirë pasi në disa raste familjet nuk pranojnë trajtimin duke e konsideruar një çështje private këtë gjë pasojat e abuzimit seksual janë të rënda për gjithë familjen, sidomos për fëmijët e tjerë në familje. Denoncimet për rastet e abuzimit janë bërë në polici nga prindërit ose të afërm të tjerë në familje.

*Rasti është referuar nga NJMF Krujë. Gjatë 2 ditëve të largimit nga shtëpia, D.P abuzohet seksualisht nga një i rritur i panjohur. Pas kësaj ngjarjeje të rëndë, gjendja psikologjike e saj nuk është e mira. Në gjendje të rënduar psikologjike ndodhen edhe motrat e saj, ku e vogla e familjes ka pezulluar mësimin për shkak të ngjarjes, ndërsa motra tjetër është e prekur me shumë edhe për faktin që vuan nga prapambetje mendore. **Krujë***

*Dyshim për abuzim seksual. Fëmija D.L 9 vjeç, dyshohet për abuzim seksual nga ana e gjyshit të tij(nga ana e nënës). Kallëzimin e ka bërë në polici gjyshja e djalit(nga ana e babait). Çështja është prej një viti në Prokurorinë e Tiranës. **Tiranë***

Rastet e abuzimit seksual janë dhe rastet më të rënda të abuzimit që përjetojnë fëmijët, dhe kërkojnë ndërhyrje shumë të specializuar dhe të shtrirë në koha. Mbetet sfida shtrirja e këtij shërbimi në të gjitha bashkitë, sidomos në ato bashki ku nuk ka ekspertizë nga organizatat partnere të cilat shpesh ofrojnë këto shërbime kur mungojnë në nivel bashkie.

## **KAPITULLI VI - NDËRHYRJET, SHËRBBIMET E OFRUARA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE.**

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, bashkia ka përgjegjësi për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë kom unitarë për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës si dhe shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes alternative për fëmijët;

Ligji ka forcuar kompetencat e bashkisë lidhur me sigurimin dhe buxhetimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje , por ende ka sfida nga bashkitë për njohjen dhe marrjen e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve, sidomos lidhur me sigurimin e shërbimit emergjent 24 orësh apo shërbimet për rastet e abuzimit seksual.

### **6.1 Ndërhyrjet dhe shërbimet**

Shërbimet për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje janë të lidhura me punën që bëhet për menaxhimin e rastit. Ofrimi i shërbimeve për familjet është i lidhur me shërbimet për fëmijët. Duke qenë se problematika kryesore e raportuar është pamundësia ekonomike e familjeve , në përmbushje dhe të synimeve strategjike , për fuqizimin e familjeve të varfra dhe sigurimin që

fëmijët të mos vendosen në institucione për shkak të varfërisë, shërbimet janë orientuar drejt fuqizimit të familjeve.

**Zbatimi i** Udhëzimin nr.14. datë 10-05-2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdeset shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët në nevojë”, ka bërë që shumë fëmijë në situatë emergjente t'i ofrohet shërbimi i emergjencës 72 orësh. Ky afat është i mjaftueshëm që grupit teknik ndërsektorial që mblidhet për rastin të dalë me një vendim dhe plan individual në mbrojtje të fëmijës .

E drejta për regjistrim në lindje, përveçse është një e drejtë njerëzore, është jetike që ata të kenë akses në shërbime. NJMF-të kanë qenë aktive për çdo rast të identifikuar si i paregjistruar. Lehtësimi I proceduarve në gjendjen civile ka rritur aksesin në këtë shërbim. Për raste të ndërlikuar dhe që kërkojnë dokumentacion apo procedura ligjore, një ndihmë të çmuar ka dhënë organizata TLAS.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre hasin vazhdimisht barriera për të gëzuar të drejtat e tyre njerëzore bazë dhe për përfshirjen e tyre në shoqëri. Ata shpesh përjashtohen nga arsimimi, dhe shërbimet sociale dhe shëndetësore bazë. NJMF-të raportojnë në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aktorët lokalë kanë ndihmuar për regjistrimin dhe frekuentim të kopshteve dhe shkollave si dhe kanë referuar rastet e fëmijëve në institucionet shëndetësore për kryerjen e diagnostifikimeve dhe shërbimeve shëndetësore të nevojshme. Për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve është ofruar mbështetjeje dhe udhëzime për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar për fëmijët. Fëmijët të cilët kanë nevojë për trajtim të specializuara janë referuar në qendra ditore që ofrojnë shërbime rehabilituese dhe riintegruese për këta fëmijë.

*J. F një fëmijë 10 vjeç prej tre vitesh vazhdon të jetë në klasë të parë. Prindërit janë të shqetësuar pasi nuk ka përparuar si fëmijët e tjerë për shkak se ai është i diagnostikuar me prapambetje mendore dhe epilepsi dhe nuk ka marre zhvillimin e duhur, për këtë arsye babai i fëmijës kërkon që djali i tij të ketë një Mësues ndihmës që dhe ai të marri njohuritë e duhura si fëmijët e tjerë*

#### **Zall Bastar**

*Është referuar nga mësuesja e shkollës e cila kërkoi ndihmë që djalit ti jepet mundësia për të marrë terapi dhe logopedi nga ndonjë qendër Ditore për fëmijët me AK pasi nëna nuk ka mundësi ekonomike ta ndjekë me këto shërbime të specializuara fëmijën e saj. Oligerti është në klasën e 8, frekuenton rregullisht shkollën, ka vështirësi në të nxënë, vështirësi në të folur, nuk socializohet, kur ka qenë në moshën 1 vjeçare ka kaluar temperaturën e lartë dhe si pasojë e kësaj gjëje ka këto vështirësi. NJMF-ja ka menaxhuar rastin duke e sugjeruar tek Qendra Ditore MEDPAK për të marrë dy herë në javë shërbim logopedie falas për fëmijën. **Librazhd***

Për fëmijët të cilët merren në mbrojtje nga NJMF-të, raportohet që hartohet një Plan Individual Mbrojtjeje, me hapat që ndërmarrin aktorët dhe i detajuar me shërbimet përkatëse për fëmijët dhe familjen. Janë raportuar 705 raste të hartimit të planeve individuale. Krahasuar me numrin rasteve të reja të raportuara kjo shifër është më e vogël, që mund të jetë një tregues që NJMF-të nuk hartojnë plan mbrojtje për çdo rast të raportuar si rast i ri, pasi kryesisht PIM hartohen për rastet me rrezik të mesëm, të latë apo të menjëhershëm. Për rastete me rrezik të ulët NJMF-të bashkëpunojnë me një ose dy aktorë të nevojshëm për zgjidhjen e rastit.

Shërbimet ofrohen sipas nevojave. Për familjet pamundësi ekonomike që është dhe nga problematikat më të hasura ofrohen shërbime në ndihmë të familjeve dhe të fëmijëve, me qëllim fuqizimin e tyre. Futja në skemën e ndihmës ekonomike, punësimi i prindërve, ndihma në bazë materiale dhe paketa ushqimore janë shërbime që ofrohen më së shumti. Prindër të fëmijëve janë asistuar nga NJMF-të asistimin për përfitim nga fondet për banesa sociale, ndihma nga bashkitë për rregullimin e banesave, drejtim për tek zyrat e strehimit etj. Për fëmijët janë ofruar dhe bursa për ndjekjen e shkollës së mesme.

Për rastet e dhunës në familje të cilat sipas raportimeve janë dyfishuar janë asistuar me shërbim psikologjik. Në të shumtën e rasteve mbështetja është gjetur nga bashkëpunimi me shërbimin psikologjik shkollor. NJMF ka mbajtur kontakte të rregullta me shkollën për këto raste. Këshillim psikologjik i specializuar për raste abuzimi por që ofrohet vetëm me ndihmën e OJF.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore, të ligjit të ri për fëmijët nr. 18/2018 si dhe ligji Nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, NJMF-të raportojnë që janë bërë pjesë e seancave gjyqësore. Ligji ka parashikuar që për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin autoritetet përgjegjëse, caktojnë persona të specializuar që në bashkëpunim me fëmijën, prindërit për zbatimin e kujdesit të vazhdueshëm mbi personalitetin dhe sjelljen dhe trajtimin e tij. Përfshirja e NJMF në këtë grup të specializuar përbën një sfidë të re për punën e NJM e cila do të kërkojë dhe trajnim të NJMF-të në këtë drejtim.

*NJMF ka marrë pjesë në seanca gjyqësore për të ndjekur vendimet e gjykatës si dhe për tu njohur me planin e rinteprimit për 2 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin. **Berat***

Ka raste kur prindërit, nuk kanë aftësitë e duhura për t'u kujdesur për fëmijët që kanë nevojë për kujdes prindëror. NJMF kanë ndjekur procedurat për kujdestarinë në familjet në lidhje gjaku si alternativa e parë për sistemim të fëmijëve. Kur nuk ka qenë e mundur kjo në bashkëpunim me Shërbimin social në bashki dhe atë rajonal është mundësuar ofrimi i shërbimit në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror

*Pas procedurave të zhvilluara dhe deklaratës së nënës, fëmija është në kujdestari alternative tek gjyshërit e saj. Ata janë të moshës 50 dhe 48 vjeç. Gjyshja është edukatore. Fëmijës i janë ofruar veshmbathje, paketa ushqimore. **Dibër***

Regjistrimi i fëmijëve të paregjistruar është një tjetër nga shërbimet e shpeshta që raportohet nga NJMF-të. NJMF-të ndjekin të gjitha procedurat dhe sigurojnë dokumentacionin për regjistrimin në gjendje civile të fëmijëve të paregjistruar.

## 6.2 Funksionimi i grupit teknik ndërsektorial (GTN)

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” ka përcaktuar në mënyrë specifike që në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet *ad-hoc*, grupi teknik ndërsektorial (GTN) i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Në zbatim të tij është në proces miratimi VKM për funksionimin e (GTN) e cila do të përcaktojë saktësisht rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve pjesëmarrës në GTN. Me miratimin e ligjit të ri, detyrimi për bashkëpunim ndërsektorial ka nxituar funksionimin më të mirë ndërsektorial, duke shënuar rritje të numrit mbledhjes së GTN-ve në bashkitë dhe njësitë administrative. Për vitin 2018 janë 50 bashki nga 133 që kanë raportuar dhe njësi administrative të cilat kanë mbledhur të paktën një herë GTN. Një pjesë e madhe e NJMF-ve raportojnë që ka pasur një pjesëmarrje të konsiderueshëm të aktorëve përkatës të cilët marrin pjesë dhe janë aktivë në takimet ndërsektoriale. Bashki të mëdha si Berat; Dibër, Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Pogradec, Sarandë, kanë raportuar funksionimin e GTN dhe mbledhjen e tyre për rastet sipas nevojës. Por dhe bashki më të vogla si Ujra Vajgurore, Çorovodë, Kamzë, Kavajë, Delvinë, Burrel, Patos, Klos, Fushe-Krujë, Nikël, Thumanë, Shushicë, Shirgjan, Cërrik; Bilisht, Vau Dejës, Librazhd, Gramsh, raportojnë që janë mbledhur disa herë për trajtimin e rasteve në GTN.

Veçohen në raportim njësitë administrative të bashkisë Tiranë të cilat raportojnë për funksionim dhe menaxhim të shumë rasteve, për vetë shtrirjen që ka bashkia Tiranë dhe njësitë administrative të saj dhe numrin e madh të fëmijëve në territor.

NJMF-të ndryshme raportojë që kanë mbledhur GTN sipas rastit, por ka dhe NJMF që raportojnë që nuk kanë mbledhur GTN, ose se nuk kanë pasur raste, ose nuk japin informacion për mbledhjen e tij. Bashkitë Peshkopi, Ballsh, Lezhë, Vlore, Shkodër, Njësitë administrative të bashkisë Tiranë Nr.1; Tirane Nr.6; raportojnë që GTN-ja është mbledhur më shumë se 1 herë, me pjesëmarrjen e aktorëve përkatës.

Aktorët vendorë, nën koordinimin e NJMF bashkëpunojnë në GTM sipas përgjegjësive të përcaktuara në ligj dhe udhëzimin për bashkëpunimin e aktorëve lokalë për rastet e fëmijëve që janë në nevojë për mbrojtje. Në takime ftohen aktorët e nevojshëm që lidhen me rastin. Disa prej NJMF-ve raportojnë që GTN janë mbledhur dhe për rivlerësimin e rasteve, që është një detyrimi i përcaktuar në ligjin e ri nr18/2017.

Për nivelin e rrezikut NJMF-te jo në të gjitha rastet e përshkruajnë nivelin e rrezikut, edhe pse e raportojnë atë me shifra. Mospërshkrimi i nivelit të rrezikut, kufizon informacionin për mënyrën e menaxhimit të rastit. Për rastet e raportuara në nivel të lartë janë organizuar GTN dhe kryesisht janë marrë masa për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative. NJMF-të kanë filluar të zbatojnë në praktikë ligjin e ri për të fëmijët, duke aplikuar masat e mbrojtjes për vendosjen në

përkujdesje alternative të fëmijëve me vendim të drejtorit të shërbimit social në bashki dhe më pas të validuar nga gjykata. Pas trajnimeve të zhvilluara për ligjin dhe mbështetjes teknike vazhdueshme të Agjencisë për aplikimin e masave të mbrojtjes, janë zbatuar në shumë bashki procedurat për masat e mbrojtjes, kryesisht ato për vendosjen në përkujdes alternative të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Për rastet me rrezik të mesëm dhe të lartë raportohet mbledhja e GTN me pjesëmarrjen e aktorëve sipas rastit.

Raportohet që mbledhen aktorët kyç të nevojshëm që lidhen me rastet. Aktorët kryesorë që bashkëpunojnë janë mësues dhe psikologë shkollorë, përfaqësues të policisë, shërbimit social shtetëror, NJMF në Bashki, Koordinatori i Dhunës në Familje, përfaqësues të qendrës, psikologe, administratore sociale, përfaqësues të OJF.

*Grupi teknik multidisiplinar është mbledhur për të gjitha rastet, ku aktorët kanë marrë përgjegjësitë sipas fushave që mbulojnë; policia ka bashkëpunuar për sigurinë e fëmijës; drejtorja e shërbimit social pranë bashkisë Dibër ka ofruar asistencën me ushqime dhe nevoja të tjera, shërbimi social shtetëror për vlerësimin e dosjes dhe sigurimin e një ambienti të përshtatshëm për fëmijën. **Dibër***

*Mbledhja e grupit teknik bëhet në varësi të rastit, pjesëmarrës janë pothuajse gjithmonë Shërbimi Social Rajonal, Drejtorja Arsimore, Drejtorja e Shëndetit Publik, Policia dhe organizatat: Eorld Vision, Terre des hommes dhe Kryqi i Kuq. **Lezhë***

*Kemi mbledhur grupin multidisiplinar dhe kemi hartuar plan individual për fëmijën, ku secilit anëtarë i është dhënë roli përkatës. Te pranishëm kanë qene dhe prindërit dhe fëmija vet, kemi punuar me këta aktore në mënyrë që të ndryshonte sjellja e fëmijës. **Ballsh***

Në takimet e GTN, sipas ligjit mund të ftohen të marrin pjesë prindër/kujdestarë të fëmijës, por dhe fëmijë bazuar në moshën dhe aftësinë e tij në të kuptuar. Ndërsa për prindër raportohet që kanë marrë pjesë në GTN, për pjesëmarrjen e fëmijëve në GTN rrallë raportohet që marrin pjesë fëmijë. Ka pasur dhe raste kur edhe pse janë ftuar fëmijë të marrin pjesë në GTM, ata nuk kanë pranuar të marrin pjesë.

*Familjaret e fëmijëve të rasteve që janë trajtuar në takim kanë qenë të gatshëm për të qenë të pranishëm gjatë mbledhjes. **Gramsh***

Raportohet edhe për raste kur GTN janë mbledhur për rishqyrtimin e rasteve, ku janë ftuar dhe kanë marrë pjesë të njëjtët aktorë pjesëmarrës në takimin e mëparshëm.

Lidhur me funksionimin e GTN raportohen dhe problematika të funksionimit të tij. Ka bashki ose njësi administrative që raportojnë që GTN nuk është mbledhur për tremujorin e fundit 2017.

Arsyet janë se nuk kanë pasur raste për menaxhim, por dhe raste kur nuk ka pasur gatishmëri nga aktorët vendorë.

*GTN-ja nuk mbledhur , pasi me organizimin e ri ka pasur ndryshim të personave , anëtare të GTN. **Ishëm.***

*Aktoret janë të gatshëm për bashkëpunim, por nuk ka pasur raste të reja , prandaj nuk është thirrur mbledhja e GTN. **Koplik.***

### 6.3 Vizitat në familje

Ky kapitull lidhet me përshkrimin dhe numrin e vizitave të kryera në familje nga NJMF. Vizitat në familje kryhen nga NJMF me qëllim identifikimin e rasteve të reja, vlerësimin e fëmijës dhe familjes si dhe monitorimin e rasteve që janë në menaxhim.etj.

NJMF raportojnë që kanë realizuar vizita në të gjitha rastet që janë menaxhuar, kurse disa të tjera kanë bërë vizita në familje për rastet problematike.

Vizitat në familje shpesh raportohen që janë realizuar në bashkëpunim me administratorin social i cili bën verifikimin e gjendjes social ekonomike të familjeve. Në rastet kur NJMF e mbulon dhe këtë detyrë, vizita në familje bëhet për të dyja funksionet; si për vlerësimin e situatës social ekonomike të familjeve, por dhe njohjen nga afër të rreziqeve me të cilat mund të përballen fëmijët, ndjekjen e rasteve që janë në menaxhim , vlerësimin e rrishtit, monitorimin e planit të mbrojtjes. Në varësi të rastit realizohet dhe frekuenca e vizitave në familje. Për rastet e fëmijëve në situatë rrugë , vizitat janë më të shpeshta pasi dhe puna me familjen kërkon më tepër përkushtim dhe ndjekje nga ana e NJMF-ve. Vizita në përgjithësi realizohen nga NJMF në bashkëpunim me aktorë të tjerë , si për çështje të sigurisë së NJMF ashtu dhe për të garantuar një proces vlerësimi sa më cilësor .

Vizitat në familje	
Viti 2016	Viti 2017
1740 vizita	2260
1352 raste të menaxhuara.	1650 raste te menaxhuara

Siç vërehet nga tabela, gjatë vitit 2017 NJMF-të kanë realizuar një numër të konsiderueshëm më të madh vizitash se në vitin e kaluar, të cilat korrespondojnë dhe me numrin më të madh të rasteve të menaxhuara.

Qëllimi i vizitave raportohet në mënyra të ndryshme nga NJMF-të, siç është njohja me gjendjen ekonomiko sociale të familjeve, evidentimi i problematikave të fëmijëve por vlerësimi i rasteve, intervistat në familje, monitorimi e rastit. Vizitat bëhen për monitorim të rasteve të identifikuara dhe atyre në proces menaxhimi, ndjekjen e planit të mbrojtjes. NJMF-të raportojnë që i vlerësojnë si të rëndësishme këto vizita, pasi ato mbeten jo vetëm japin mundësi për të marrë më shumë informacion rreth rastit por krijon besueshmëri tek familjarët, rrit motivimin e tyre për tu impenjuar në zgjidhjen e problematikave dhe ndërton planin e ndërhyrjes duke i bërë edhe ata pjesëmarrës.

*Vizitat në familje gjithmonë krijojnë një atmosferë pozitive me rastet pasi ata motivohen edhe më shumë për të bashkëpunuar me NJMF-në dhe rritja e sensibilizimit të tyre në ambientin ku jetojnë ka ndikim më të madh sesa në zyrë apo mjedise të tjera. **Korçë***

Por vizitat nuk kufizohen vetëm në familje, por sipas rastit NJMF-të vizitojnë fëmijët në kopshte, çerdhe dhe shkolla.

Gjatë raportimit të vizitave janë konstatuar edhe problematika të tilla që lidhen me numrin e madh të rasteve urgjente që duhej të bëhej vizita në familje dhe pamundësia për t'u realizuar njëkohësisht nga një NJMF e vetme, kjo sidomos në bashkitë e mëdha ku numri i rasteve urgjente është më i madh.

Në raportimet e ndryshme periodike tremujore, ka raste kur NJMF-të raportojnë në njëjtën mënyrë, pa treguar një vlerësim cilësor për mënyrën si i realizojnë, qëllimin e tyre, ndikimin dhe rezultatet e vizitave në menaxhimin e rastit.

Vështirësi për të mbuluar me vizita gjithë zonën që kanë në administrim mbetet ende një sfidë e raportuar nga NJMF-të.

#### 6.4 Problematikat e raportimit dhe punës për menaxhimin e rasteve

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri roli dhe kompetencat e bashkisë janë forcuar. Kjo është reflektuar dhe në numrin në rritje të rasteve të trajtuara dhe masat e mbrojtjes të dhëna nga GTN në bashkitë e ndryshme për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Por në disa raste me rrezik të menjëhershëm edhe pse GTN ka marrë vendime për marrjen në mbrojtje të menjëhershme dhe aplikimin e masës emergjente të mbrojtjes (Ligj 18/2017 neni 56/1). Ky vendim është konfirmuar nga drejtori i shërbimeve shoqërore në bashkinë. Por më pas ka pasur vështirësi në ekzekutimin masës emergjente dhe sistemin e fëmijës në përkujdes alternativ. Edhe pse NJM-të kanë ndjekur rastin deri në orët e vona të natës, ka pasur raste që

fëmija nuk është sistemuar në institucionin e përkujdesit social, për mungesë koordinimi me këto institucione. Në këto raste fëmijët janë sistemuar në qendrat e emergjencës jopublike.

Raportimi për mënyrën e menaxhimit të rasteve bëhet i pjesshëm. NJMF-të raportojnë problematikën dhe ndërhyrjen që kanë realizuar, por pa treguar proceduarën që kanë zbatuar, pjesëmarrjen e aktorëve dhe si ka ecur monitorimi i rastit.

Janë vetëm pak NJMF që raportojnë që kanë bërë rivlerësim të rasteve. Edhe pse mund të ndodhë në praktikë, rivlerësimi si një proces i natyrshëm gjatë menaxhimit nuk gjen pasqyrim në raportet periodike

Mungesa e qendrave të trajtimit të rasteve të fëmijëve me çrregullim në sjellje është raportuar si problematikë. Këto qendra mungojnë në disa bashki dhe kjo vështirëson menaxhimin e rasteve të tilla dhe ofrimin e shërbimit të specializuar.

Praktika dhe nga kontakti i vazhdueshëm me NJMF-të rezulton që rastet fillojnë të trajtohen atëherë kur është niveli i rrezikut i lartë dhe më pak punohet në parandalimin e rasteve dhe trajtimin e tyre që në nivelin e ulët dhe të mesëm, pa arritur në nivel të lartë rreziku.

Ndryshimi i shpeshtë pozicioneve të NJMF ka çuar në nevojën për rritje të kapaciteteve të NJMF-ve të reja .

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, janë shpërndarë trajnime në 12 qarqe dhe bashki. Por ende vërehet paqartësi në interpretimin e ligjit dhe aplikimin e masave të mbrojtjes për kategoritë e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Stafi i agjencisë ka ofruar mbështetje teknike të vazhdueshme për procedurat që duhet të ndiqen dhe marrjen e masave të mbrojtjes. Në shumë rastet pas asistencës NJMF-të së bashku me GTN kanë marrë vendimin për pasi të vlerësohet që fëmijët janë në nevojë për mbrojtje, atëherë të nisen procedurat për marrjen e masës së mbrojtjes sipas ligjit 18/2017.

Problematikë paraqet rasti kur me gjithë shërbimet e ofruara, familjet nuk janë bashkëpunuese .

Bashkëpunimi i NJMF me policinë, shëndetësinë, apo arsimin në këto raste ka nevojë të përmirësohet duke kryer në kohë referimin e ndërsjelltë mes institucioneve dhe NJMF-ve.

Një nga problematikat kryesore mbetet mungesa e shërbimeve të përshtatshme në territor, duke u bërë pengesë në vendimmarrjen gjatë takimeve.

Edhe pse shpesh i ngritur si problem pranë bashkive, mungon shërbimi i specializuar psikologjik. Edhe pse për trajtimin e rasteve është kërkuar bashkëpunimi i psikologëve shkollorë, ka raste të cilat nuk mund të mbulohen nga ky shërbim. Është e nevojshme që struktura e shërbimeve sociale në çdo bashki të ngrejë këtë shërbim të specializuar.



Caktimi i punonjësi të NJMF me profil punonjës social, është një domosdoshmëri e përcaktuar në ligjin e ri për fëmijët, por ende një numër I madh NJMF nuk kanë ene këtë formim.

Agjencia ka konstatuar dhe problematika që lidhen me mënyrën e raportimit periodik pranë ASHMDF nga NJMF-të. Ka raste raportimi i NJMF-ve është me pasaktësi dhe indikatorët nuk plotësohen të qartë sipas kërkesës, ose ngatërrohen indikatorët mes tyre.

Informacioni për problematikat e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje është i pjesshëm, shpesh vetëm përmendet problematika pa shpjeguar mënyrën e trajtimit dhe ecurinë e rastit. Informacioni për rastet e mbartura, dhe pse është kërkuar si një risi në formularët e fundit , nuk raportohet nga të gjitha NJMF-të. Gjithashtu informacion mbi vizitat në familje është i mjaftueshëm , ose nuk përmendet fare.

Me daljen e VKM për mbledhjen e të dhënave statistikore në nivel qendror dhe vendor mbi çështjet e mbrojtjes dhe të të drejtave të fëmijëve që pritet të dalë në zbatim të ligjit të ri nr. 18/2017 mënyra e raportimit do të saktësohet dhe do të jetë një detyrim për NJMF-të.

## **KAPITULLI VII- FËMIJËT NË SITUATË RRUGE**

Fëmijët në situatë rruge janë një nga kategoritë më të rrezikuara për sa i përket cënimit të të drejtave kryesore që çdo fëmijë duhet të gëzojë. Përgjatë vitit 2017 është përforcuar puna e të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe vendor duke u reflektuar në plotësim të kuadrit ligjor si dhe rritje e rasteve të identifikuar dhe menaxhuara të fëmijëve në situatë rruge.

Por procesi i implementimit të planeve lokale për fëmijë në situatë rruge ka hasur pengesa të cilat do të trajtohen në këtë kapitull. Planet Kombëtar i Veprimt për Fëmijë në Situata Rruge 2015 – 2017 ka gjetur zbatim në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Fier, Elbasan, Korçë, Krujë dhe Kavajë.

### **7.1 Kuadri ligjor për fëmijët në situatë rruge**

a) *Ligj 18-2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*

Ligj "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" – u miratua në Parlament ne Shkurt të vitit 2017.

Ligji parashikon për herë të parë një sistem gjithëpërfshirës te mbrojtjes se fëmijëve duke ripërcaktuar qarte detyrat e mekanizmave institucionale dhe strukturave te mbrojtjes se fëmijëve ne nivel qendror dhe ne nivel lokal, duke e koordinuar me ligjin e ri për shërbimet sociale dhe ndarjen e re territoriale të vendit.

Ligji përveç të drejtave të fëmijëve, trajton për herë të parë aspektin e mbrojtjes së fëmijëve, gjë e cila reflektohet që në titull dhe me pas shtjellohet duke parashikuar masat mbrojtëse që jepen nga strukturat e pushtetit vendor dhe gjykata.

Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik është e parashikuar si kategori fëmijësh për të cilët duhet siguruar mbrojtje e posaçme – Kreu V Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Konkretisht mbrojtja e kësaj kategorie është parashikuar në nenin 24 dhe 64 të ligjit 18/2017 :

Neni 24 - Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- b) cenon edukimin;
- c) është e detyruar.

Neni 64 - 1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës kanë për të detyrë të identifikojnë në mënyrë aktive dhe të trajtojnë me përparësi çdo rast të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Këto struktura janë përgjegjëse dhe kanë të drejtë të ndërmarrin veprime konkrete, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik apo situata e rrugës. Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

*b) Kodi i Drejtësisë penale për të mitur*

Më datë 1 janar 2018 ka hyrë në fuqi Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ku në mënyrë specifike parashikon dhe detyrat e NJMF.

*c) Planet Lokale për Fëmijët në Situatë Rruge*

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës“ parashikon në nenin 46 detyrimin e bashkive për pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare.

Në Objektivin 3 të Agjendës Kombëtare të Drejtave të Fëmijëve 2020, e miratuar me VKM Nr 372 datë 26.4.2017 parashikohet hartimi i planeve lokale për mbrojtjen e fëmijëve si pjesë e planeve lokale sociale.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ka koordinuar procesin e hartimit të planeve lokale për fëmijë në situatë

rruge dhe po monitoron implementimin e tyre në bashkitë: Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër, Korçë, Vlorë.

Në vitin 2017 me mbështetjen e Save the Children janë draftuar dhe Planet lokale me fokus fëmijë në situatë rruge në bashkitë Berat dhe Sarandë. Gjithashtu Organizata Arsis me mbështetjen e Save the Children prej muajit maj 2017 ofron mbështetje direkte për Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës në identifikimin në terren dhe menaxhimin rasteve të fëmijëve në situatë rruge.

Procesi i hartimit të planit lokal do të përfshijë disa faza dhe kërkon ndërhyrje të qëndrueshme dhe ndër-sektoriale për adresimin e identifikimit, referimit dhe menaxhimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

*d) Draft VKM për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik*

Në zbatim të Ligjit 18-2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës“ me mbështetjen e Prezencës së OSBE ‘së në Shqipëri është draftuar VKM për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”. Kjo VKM parashikon institucionet përgjegjëse dhe detyrimet e tyre për identifikimin dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht.

*e) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2020*

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020, e miratuar më VKM nr. 372, datë 26.4.2017 në Objektivin nr. 4 “Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve” parashikon:

Pika 4.4. Mekanizmi për mbrojtjen e fëmijëve nga puna e detyruar dhe trafikimi:

- a) Vlerësimi i situatës së punës së fëmijëve në Shqipëri
- b) Udhëzues për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për të vlerësuar punën e fëmijëve
- c) Zgjerimi i termave të referencës të pozicionit të inspektorëve të punës, duke përfshirë inspektimin për punën e detyruar të fëmijëve dhe trafikimin e tyre
- d) Shtimi i numrit të punonjësve të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale me 20%

## 7.2 Identifikimi dhe menaxhimi i fëmijëve në situatë rruge

Përgjatë vitit 2017 kanë qenë **aktive 29 skuadra terreni** të cilat **kanë identifikuar 484 fëmijë** në situatë rruge në bashkitë :Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan, Vlorë. Korçë, Krujë dhe Kavajë. Nga këto 484 raste, 381 janë raste të identifikuara për herë të parë në situatë rruge.

Këto skuadra monitorojnë hapësirat publike, kryesisht në zonat që njihen si më të frekuentuara nga fëmijët e këtij grupi, për të identifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë fëmijët në situatë rruge, për të dhënë ndihmën e parë dhe për të bërë referimin e menjëhershëm tek strukturat përgjegjëse për menaxhimin e rastit. Skuadrat e Terrenit për Identifikimin, Ndihmën dhe Referimin e Fëmijëve në Situatë Rruge ngrihen pranë institucionit Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashki dhe do të përbëhen nga të paktën 2 punonjës socialë: 1 Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Njësisë Vendore dhe 1 punonjës social me përvojë i caktuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki dhe/ose një punonjës social nga organizatat e shoqërisë civile.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka mbështetur bashkinë Tiranë në identifikimin në terren me një skuadër terreni e cila ka bërë identifikimin në orët e pasdites për periudhën janar – qershor 2017.

	<b>Bashkia</b>	<b>Nr. i skuadrave të terrenit</b>
<b>1</b>	Tiranë	4
<b>2</b>	Durrës	3
<b>3</b>	Fier	1
<b>4</b>	Shkodër	5
<b>5</b>	Vlorë	4
<b>6</b>	Elbasan	5
<b>7</b>	Korçë	2
<b>8</b>	Krujë	3
<b>9</b>	Kavajë	2
	<b>Total</b>	<b>29</b>

Tabela nr. 1 – Numri i skuadrave të terrenit në bashki

	<b>Bashkia</b>	<b>Nr. i rasteve të identifikuara në total në 2017</b>	<b>Nr. i rasteve të përsëritëse të identifikuara në 2017</b>	<b>Nr. i rasteve të reja të identifikuara në 2017</b>
<b>1</b>	Tiranë	302	52	250
<b>2</b>	Durrës	57	0	55
<b>3</b>	Fier	12	0	12
<b>4</b>	Shkodër	41	35	6
<b>5</b>	Vlorë	20	4	16
<b>6</b>	Elbasan	15	0	15
<b>7</b>	Korçë	21	5	16
<b>8</b>	Krujë	5	0	5
<b>9</b>	Kavajë	11	5	6
	<b>Total</b>	<b>484</b>	<b>101</b>	<b>381</b>

Tabela nr. 2 – Rastet e identifikuara

## 2. Menaxhimi i fëmijëve në situatë rruge

Për vitin 2017 janë në proces menaxhimi 251 raste të fëmijëve të identifikuara në situatë rruge në 9 bashkitë ku është shtrirë Plani Kombëtar i Veprimit për fëmijë në situatë rruge 2015 – 2017.

	<b>Bashkia</b>	<b>Nr. i rasteve të menaxhuara në total në 2017</b>
<b>1</b>	Tiranë	196

2	Durrës	55
3	Fier	12
4	Shkodër	38
5	Vlorë	6
6	Elbasan	15
7	Korçë	14
8	Krujë	5
9	Kavajë	11
	<b>Total</b>	<b>352</b>

Tabela nr. 3 – Rastet e menaxhuara

Shërbimet e ofruara janë kryesisht

- Referim për regjistrim në shkollë, monitorim e ecurisë së shkollimit
- Referim të prindërve për punësim
- Shoqërim në qendrat shëndetësore, vaksinim, hapje e kartelave të shëndetit
- Shërbim emergjence për rastet e identifikuar në rrezik të lartë
- Mbështetje me pako ushqimore
- Mbështetje me bonus qiraje
- Mbështetje me kurse profesionale
- Mbështetje në vetëpunësim
- Kallëzim në polici për rastet ku është konstatuar keqtrajtim i të miturit

Në mënyrë specifike janë ofruar shërbimet e mëposhtme me të dhënat në shifra përkatëse:

a) Procesi i regjistrimit të fëmijëve në situatë rruge në kopshte dhe shkolla

Ministria e Arsimit dhe Sportit, si palë e marrëveshjes 3 ministrore “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” ka luajtur një rol kyç në regjistrimin e fëmijëve të identifikuar në situatë rruge në këto bashki.

Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizatat që punojnë për fëmijët në situatë rruge dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale kanë identifikuar dhe hartuar listat me fëmijë në situatë rruge.

**Për vitin shkollor 2017 – 2018 janë regjistruar në sistemin arsimor të detyrueshëm 208 fëmijë të identifikuar në situatë rruge.**

b) Shërbimi emergjent

Pas miratimit të udhëzimit për shërbimin emergjent (Nr.14/2016) në bashkitë Durrës, Shkodër, Tiranë, Korçë, pranë institucioneve të përkujdesit social janë ngritur dhomat e emergjencës të cilat ofrojnë shërbim 72 orësh për rastet e identifikuar në rrezik të lart.

### Shërbimi Emergjent

Shërbimi I Emergjences Ne Bashkine:	Nr. i rasteve ne shërbim emergjence
<b>Tirane</b>	5
<b>Durres</b>	7
<b>Korce</b>	1 ”
<b>Vlore</b>	0
<b>Shkoder</b>	8
<b>Arsis</b>	60
<b>Total</b>	81

Tabela nr. 4. – Nr. i rasteve të cilat kanë marrë shërbim emergjent

c) Raste të vendosura në institucione rezidenciale të përkujdesit social

Ndarja e fëmijës nga familja është hapi i fundit, i cili ndërmerret në menaxhimin e një rasti në nevojë për mbrojtje. Në rastet kur fëmijët kanë mbetur pa kujdes prindëror apo janë ezauruar të gjitha shërbimet mbështetëse dhe rasti vijon të qëndrojë në situatë rruge dhe rrezik të lartë, grupet teknike ndërsektoriale kanë dalë me vendimin e vendosjes së fëmijës në institucion rezidencial rezidenciale të përkujdesit social

#### RASTE TË VENDOSURA NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT REZIDENCIAL

Bashkia	Nr. i rasteve të vendosur ne Institucion me kërkesë të NJMF
<b>Tirane</b>	14
<b>Durres</b>	3
<b>Fier</b>	0
<b>Vlore</b>	2
<b>Elbasan</b>	1
<b>Korce</b>	1
<b>Shkoder</b>	5
<b>Cerrik</b>	1

<b>Kruje</b>	0
<b>Kavaje</b>	0
<b>Total</b>	27

Tabela nr. 5 – Raste të vendosura në institucion përkujdesit rezidencial

d) Punësimi

Një ndër sfidat më të mëdha në të gjithë procesin e menaxhimit të të rasti fëmija në situatë rruge është punësimi dhe fuqizimi ekonomik i familjes. Mungesa e vullnetit për punë nga ana e prindërve si dhe mungesa e vendeve të punës në treg në përputhje me formimin e tyre, bën që shumë raste të mos punësohen.

<b>Bashkia</b>	<b>Referuar për punësim</b>	<b>Punësuar</b>
Tirane	21	15
Durrës	5	4
Fier	3	1
Vlore	1	1
Elbasan	3	2
Korçe	4	2
Kavaje	1	1
Shkodër	6	3
<b>Total</b>	<b>44</b>	<b>29</b>

Tabela nr. 6 – Raste të punësuara

e) Regjistrimi në gjendje civile

Për përfitimin e shërbimeve në një njësi administrative është e domosdoshme pasja e gjendjes civile në atë territor. Për fëmijët të cilat kanë lëvizur nga një bashki në tjetër për të jetuar është bërë dhe transferimi i gjendjes civile dhe për ato raste të cilat nuk kanë figuruar në regjistër të gjendjes civile, është bërë i mundur regjistrimi për herë të parë.

<b>Bashkia</b>	<b>Referuar për regjistrim ne gjendje civile</b>	<b>Regjistruar</b>
Tirane	19	7
Durrës	0	0
Fier	0	0
Vlore	1	1
Elbasan	2	2

Korçë	3	3
Shkodër	11	11
<b>Total</b>	<b>36</b>	<b>24</b>

Tabela nr. 7 – Regjistruar ne gjendje civile

#### f) Kallëzimet penale

Për vitin 2017 janë bërë **15 kallëzime penale** nga Punonjëset për mbrojtjen e fëmijës. 13 kallëzime në bashkinë Tiranë, 1 në Vlorë dhe 1 në Shkodër. Nga 15 raste e kallëzuara për keqtrajtim të mituri, 2 janë dënuar me masën arrest me burgim. Rastet e tjera janë në proces gjykimi në gjendje të lirë.

### 7.3 Unifikimi i databazës për fëmijë në situatë rruge

Çdo muaj Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dërgojnë elektronikisht pranë ASHMDF databazën me identifikimet e bëra në terren dhe shërbimet e ofruara për fëmijë në situatë rruge. Ekipi për fëmijë në situatë rruge çdo muaj ka përditësuar dhe unifikuar një databazë të përgjithshme me të gjithë fëmijët e identifikuar në 7 bashkitë.

Kjo databazë shërben për të identifikuar rastet përsëritëse në rruge, fëmijët e larguar nga situata e rrugës, zonat më problematike, rastet lëvizëse nga nja bashki në tjetrën si dhe shërbimet dhe masat e ndërmarra për çdo rast.

### 7.4 Aktivitete

#### ➤ Mbështetja me bursa për kurse profesionale

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, përgjatë vitit 2017, ka realizuar ndarjen e 33 bursave profesionale për të rinj në bashkitë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Fier. Financimi i bursave është një nga aktivitetet e projektit të OSBE “Për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi”.

Përfituesit janë fëmijë të moshës 14-18 vjeç, në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi, siç janë identifikuar nga analiza e situatës të kryer nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në konsultim me ASHMDF-në dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve. Pas përfundimit me sukses të programeve të kurseve profesionale, u shpërndanë certifikata. Programi i bursave profesionale ka reduktuar pozitiv , jo vetëm në identifikimin e rasteve por edhe ne orientimin e tyre drejt arsimit profesional.

#### ➤ 12 Prill ‘ Dita ndërkombëtare e fëmijëve në situatë rruge

12 Prill është Dita ndërkombëtare e fëmijëve në situatë rruge. Në vitin 2017 në këtë datë u shënuar dhe 1 vjetori i themelimit të Rrjetit të Qendrave ditore për fëmijë në situatë rruge.

Në këtë ditë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Rrjetin e Qendrave ditore për fëmijë në situatë rruge dhe Organizatën Save the Children,



organizuan një aktivitet për fëmijët e identifikuar në situatë rruge në bashkinë Tiranë. Aktiviteti u shoqërua me lojëra dhe animacione për fëmijët dhe u përshëndet nga Ministria e Mirëqenies dhe Rinisë Znj.Olta Xhaçka dhe Zv.Kyetar i Bashkisë Tiranë Z.Andi Seferi.

- Dita Ndërkombëtare kundër punës së detyruar të fëmijëve

12 Qershori shënon Ditën Ndërkombëtare kundër punës së fëmijëve. Çdo fëmijë ka te drejte të mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik që përfshin kryerjen e çdo pune që paraqet rreziqe për shëndetin fizik e mendor dhe që cenon edukimin e tyre. Në këtë datë u realizua një vizitë në Qendrën Tjetër Vizion se bashku me Koordinatorin Antitrafik Znj.Anila Trimi, Zv. Ambasadorin e Prezencës së Osbe-së në Shqipëri Z. Robert Ēilton dhe aktore lokale për të parë nga afër praktikën pozitive të identifikimit të fëmijëve në situatë vulnerabël dhe orientimin e tyre drejt kurseve profesionale si një hap i parë i parandalimit të punës së detyrueshme dhe zgjedhjes së tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

- Dita e parë e shkollës. Mbështetje me mjete shkollore dhe çanta për fëmijët në situatë rruge të identifikuar në Tiranë që janë regjistruar në shkollë

Për të lehtësuar frekuentimin në shkollë të fëmijëve të identifikuar në situatë rruge dhe regjistruar në shkollë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Kryeqin e Kuq Shqiptar organizuan një aktivitet ku u shpërndanë 100 çanta dhe mjete didaktike për këta fëmijë.

- Me rastin e festave të fundvitit Agjencia në partneritet me Fondacionin Alo Mik, kompaninë Eurolab organizuan një aktivitet festiv **“Festojmë së Bashku”** me fëmijët në nevojë për mbrojtje që menaxhohen nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe që marrin shërbime pranë qendrave ditore të organizatave Shkej dhe ARSIS. Qëllimi i aktivitetit ishte që të festojmë së bashku me fëmijët në nevojë për mbrojtje, të cilët nuk kanë mundësi të festojnë si gjithë fëmijët e tjerë për shkak se prindërit e tyre nuk kanë mundësi ekonomike për t’i përgatitur dhurata e fundvitit. Në aktivitet morën pjesë 150 fëmijë në nevojë për mbrojtje, të cilët kanë marrë shërbim pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Tiranës dhe pranë qendrave ditore të organizatave Shkej dhe ARSIS. Aktiviteti u përshëndet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj.Ogerta Manastirliu .Në fund të aktiviteti fëmijëve ju shpërndan dhurata dhe ushqime.

- “Pikëz” Prezantimi i dokumentarit mbi shërbimet e ofruara për fëmijët në situatë rruge dhe i ekspozitës me foto të fëmijëve -Promovimi i të drejtave të fëmijëve në situatë rruge.

Më 7 nëntor 2017 Agjencia në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ) dhe organizatën italiane Colibrí, organizuan aktivitetin “Pikëz” pranë Qendrës Kulturore Tulla për promovimin e të drejtave të fëmijëve në situatë rruge. Qëllimi i aktivitetit ishte prezantimi i një dokumentari mbi shërbimet e ofruara për fëmijët në situatë rruge , ekspozitë me foto të fëmijëve dhe kartolina të punuara nga vetë fëmijët e qendrës ditore Shkej. Muzikë live dhe kartolina të punuara nga vetë fëmijët e qendrës ditore Shkej shoqëruan këtë mbrëmje. Fondet e mbledhura nga shitjet e biletave shkuan në ndihmë të fëmijëve të identifikuar në situatë rruge.

## 7.5 Trajnime

a. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri ka realizuar në muajin Maj 2017 - **7 trajnime** për profesionistë të cilët punojnë për mbrojtjen e fëmijëve në bashkitë: Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Elbasan dhe Korçë.

Tema e trajnimit: “Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi”. Ky trajnim kishte për qëllim përgatitjen dhe informimin e profesionistëve të kuadrit të plotë ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi si dhe parashtrimi i rasteve konkrete në proces menaxhimi nga PMF.

b. Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për fëmijë në situatë rruge 2015 - 2017 janë realizuar trajnime në bashkitë Krujë dhe Kavajë

Trajnimet janë realizuar me mbështetjen e organizatës ARSIS dhe Save the Children ku janë trajnuar rreth 60 profesionistë të cilët punojnë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në këto 2 bashki.

**c. Organizata ARSIS me mbështetjen e UNICEF ka implementuar Projektin “Mbështetja e mekanizmave dhe kapaciteteve për identifikimin, menaxhimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve viktime të dhunë”**..Projekti është zbatuar me mbështetjen financiare të UNICEF në Shqipëri për periudhën 15 Nëntor 2016-31 Dhjetor 2017. Janë realizuar në bashkitë Devoll, Peshkopi, dhe 5 Njësi Administrative në Tiranë **13 ëorkshop-e teknike** me fokus:

- profili i fëmijëve të abuzuar dhe fëmijëve në situatë rruge;
- puna dhe shfrytëzimi i fëmijëve;
- identifikimi dhe mekanizmi i referimit për raste të specifike;
- Udhëzimi për identifikimin, mbështetjen e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge;
- Udhëzimi nr.10- Protokollin e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Ligji 18/2017 Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

## 7.6 Problematikat dhe pikat e forta

Zbatimi i Planit Kombëtar për fëmijë në situatë rruge ka hasur problematika në:

- mungesa e shërbimeve të qëndrueshme dhe afatgjata
- në të gjithë vendin janë 223 PMF të emëruara zyrtarisht. Është e nevojshme përmbushja e standartit të parashikuar në ligj për cdo bashki ose njësi administrative që ka mbi 3000 fëmijë të ketë minimum nje PMF. Është shumë e rëndësishme që cdo rast i cili identifikohet në situatë rruge të menaxhohet nga PMF.
- krijimi i vendeve të punës të përshtatshme për kategorinë e prindërve të fëmijëve në situatë rruge

- Kemi rezultate me te mira në:

- procesin e identifikimit të ketyre rasteve
  - referimin dhe regjistrimin në shkollë
  - referimin dhe regjistrimin në gjendje civile
  - ka filluar zbatimin e ligjit dhe aplikimin e masave të mbrojtjes sipas parashikimeve në
  - ligj 18/2018 për rastet e identifikuara në rrezik të lartë
  - është arritur të krijohet një bashkëpunim pozitiv ndërsektorial mes institucioneve dhe ojf në menaxhimin e rasteve
- Duhet bërë më shumë në:
- fuqizimin e familjes nëpërmjet orientimit për punësim dhe arritjes së rasteve të punësimit të qëndrueshëm
  - alokimin e kuotave në kopshte dhe cerdhe për rastet e identifikuara në situatë rruge
  - buxhetimin e planeve lokale për fëmijë në situatë rruge
  - buxhetimin e planeve individuale për mbrojtjen e fëmijëve
  - bashkëpunim më i mirë me prokurorinë dhe gjykatat për ndjekjen e rasteve të cilat
  - është konstatuar vepra penale e keqtrajtimit të të miturit.

### **KAPITULLI III - MONITORIMI I MEDIAS LIDHUR ME PROBLEMATIKAT E MBROJTJES SË FËMIJËVE**

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka identifikuar dhe adresuar problematikën e shkeljeve etike dhe të të drejtave të fëmijës gjatë raportimit të rasteve të fëmijëve në media, të cilat nuk respektojnë privacinë dhe anonimatën për fëmijët.

Problematikat e konstatuara vazhdojnë të jenë: *Intervistimi i fëmijëve të keqtrajtuar në shkelje të të drejtave të fëmijës; publikimi i informacioneve që identifikon fëmijët kur ata janë viktimë të abuzimit, dhunës dhe ngjarjeve të tjera të rënda, ekspozimi i fëmijëve dhe familjeve të tyre në media, i cili bëhet shkak për mos raportimin e abuzimit etj.*

Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” bazuar në parimet themelore të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, ka përcaktuar qartë detyrimet e medias lidhur me raportimet për fëmijët:

- Ligji i ka kushtuar një nen të veçantë për lirinë e jetës private të fëmijës. Në nenin 17 të tij ligji përcaktohet që fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.
- Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, duke përfshirë publikimin e tyre në media. Edhe pjesëmarrja e fëmijëve në debate publike si dhe në programe audiovizive e cila kur fëmija është nën moshën 14 vjeç bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.

- Gjithashtu ligji i ri përcakton mbrojtje të fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik si dhe *për qëllime reklamuese*.
- Lidhur me rastet e fëmijëve në mediat online, ligji përcakton që Agjencia raporton tek autoritetet përgjegjëse për faqet me përmbajtje të paligjshme dhe të papërshtatshme për fëmijët.

Për adresimin e situatës, Agjencia ka vendosur partneritet me autoritete përgjegjëse mediatike me synim përmirësimin e situatës dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të drejtat e fëmijëve në media. Në kuadër të procesit të rishikimit të “Kodit të Transmetimit”. Agjencia ka nxitur dhe ka qenë pjesë e të gjitha takimeve konsultuese të zhvilluar në 2017. Në shtator 2017, Agjencia ka dërguar zyrtarisht propozimet e saj për ndryshime bazuar në perspektivën e ligjit të ri nr18/2018 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” të cilat janë janë reflektuar në të gjitha pikat e Kodit të ri të Transmetimit.

**41 ankesa** janë referuar nga Agjencia drejtuar mediave të shkruara dhe audiovizive për publikimin e lajmeve në shkelje të të drejtave të fëmijëve. Nga këto **10 ankesa** janë drejtuar Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe **31 ankesa** janë drejtuar gazetave dhe portaleve si dhe këshillit të medias Shqiptare.

ASHDMF ka hartuar **48 raporte** javore nga monitorimi ditor medias për vitin 2017. janë hartuar të monitorimit të medias.

**117 raste** të publikuara nga media lidhur me fëmijët në nevojë për mbrojtje janë referuar nga ASHDMF në institucionet përkatëse dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe lokal.

Miratimi i Kodit të Transmetimit të Mediave Audiovizive është një arritje në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe nga monitorimi i medias rezulton që ka një përmirësim të dukshëm lidhur me raportimet që media bën lidhur me lajme për fëmijët. Ka pasur përpjekje të mira për ruajtjen e privacisë dhe mosidentifikimin e fëmijëve në media.

Problematike mbetet media e shkruar dhe online si dhe dhe portalet online, të cilat kanë dhe përdorimin më të gjerë në popullatë. Gjatë takimeve me aktore nga mediat dhe institucionet ligjzbatuese lidhur me to, Agjencia e ka përcjellë në vazhdimësi këtë shqetësim. Rekomandimet nga këto takime kanë përcaktuar nevojën për hartimin e një Kodi Sjelljeje për gazetarët e mediave online si dhe njohjen më të mirë të ligjit prej tyre .

Edhe pse ligji imponon sanksione për raste të shkeljes së Kodit të Etikës për transmetimet Audiovizive, hapi më i rëndësishëm, është ndërgjegjësimi i gjithë aktorëve në këtë drejtim dhe sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët. Është e domosdoshme që të krijojmë një partneritet me vetë median drejt qëllimit tonë universal: mbrojtja e fëmijëve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

## KAPITULLI – VIII AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS

Ligji i ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës parashikon detyrimin ligjor të Agjencisë për të realizuar vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera, veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve si dhe të punonjësve e të funksionareve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë.

### 8.1 Aktivitete ndërgjegjësuere

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me organizatën Terre des Hommes , Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe vullnetarë nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik nr.4 ka organizuar fushatën informuese, ndërgjegjësuere mbi sigurinë e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna me nxënës dhe punonjës të institucioneve arsimore në shkollat 9 –vjeçare “7 Marsi”, “Osman Myderi, “Qazim Turdiu” dhe shkollën “Androkli Kostallari” të qytetit të Tiranës. Qëllimi i fushatës ishte informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve mbi sigurinë e mbrojtjes nëpërmjet prezantimit të broshurës “Jo Heshtjes” dhe aplikacionit [#unembrojefemijet](#). Stafet mësimore dhe nxënësit e shkollave u njohën me broshurën , aplikacionin dhe përgjegjësin për të raportuar çdo rast të dyshuar apo të dhunuar të fëmijëve pranë Njësitë të Mbrojtjes së Fëmijëve. Kjo është detyrë e të gjithëve jo vetëm e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve për të treguar dhe raportuar dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve, që të gjithë fëmijët të jetojnë të sigurt. Në mënyrë që fëmijët të jetojnë të sigurtë në një shoqëri pa dhunë ndryshimi fillon nga vetja duke raportuar çdo rast dhune aktuale ose të dyshuar ndaj fëmijëve
- *Për Ditën Evropiane të Internetit të Sigurt*, Agjencia në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike ( ALCIRT) organizuan një aktivitet me nxënësit e klasave të 7-ta të shkollës 9-vjeçare “Jeronin de Rada” të qytetit të Tiranës për lundrimin e sigurt të fëmijëve në internet. Qëllimi i aktiviteti ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve dhe mësuesve mbi internetin e sigurt. Gjithashtu ne aktivitet u prezantua dhe broshura e publikuar nga ASHMDF “ Fëmijë të sigurt në internet” . Gjatë takimit u diskutua mbi risitë e projektligjit mbi internetin e sigurt si dhe u prezantua dhe aplikacioni [#unembrojefemijet](#). Fëmijët treguan interes të lartë me këtë temë kaq shumë të rëndësishme në ditët e sotme, duke e bërë këtë aktivitet mjaft tërheqës përmes bisedave interaktive që u zhvilluan në klasë.
- Në mars 2017 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve mori pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me aktorë dhe grupe interesi mbi “Transmetimin e reklamave dhe komunikimeve tregtare - dukuri dhe qasje ligjore në tregun audioviziv”. Agjencia në këtë tryeze diskutoi disa çështje të evidentuara problematike: që edhe pse legjislati shqiptar dhe ndërkombëtar ka parashikuar mbrojtje nga keqpërdorimi i fëmijëve në reklama për efekte komerciale shpesh reklammat drejtuar fëmijëve shfaqen problematike. Bazuar në studime, reklammat që u drejtohen fëmijëve si dhe përfshirja e tyre në to, përdoret për efekte komerciale si dhe ndikojnë tek shprehitë ushqimore të fëmijëve, rritje të

obezitetit. Gjithashtu Agjencia prezantoi dhe disa rekomandime, të cilat janë: Reklammat që lidhen me fëmijët duhet monitorohen rregullisht në lidhje me ndikimin që kanë tek fëmijët dhe në përputhje me standardet e legjislacionit, çështja e reklamave për fëmijët duhet të jetë gjithnjë e me shumë subjekt i një debati me qëllim përmirësime ligjore në fushën e reklamave dhe bashkëpunim me autoritetet mediatike për vete rregullimin e përfshirjes së fëmijëve, pjesëmarrja e fëmijëve në media/ reklama duhet të jetë në përputhje me interesin më të lartë për fëmijët dhe mirërritjen dhe zhvillimin e tyre dhe reklammat në mediat audiovizive duhet të rrisin rolin promovua të të drejtave të fëmijëve në media.

- Të mobilizuar për mirëqenien e komunitetit romë të Landfillit të Sharrës, Agjencia në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Fondacionin Alo!Mik, me 20 prill organizuan një takim multidisiplinar për kapitalizmin e projektit “Fëmijët, referencë e të ardhmes” me qëllim Integrimin e Komunitetit Rom në Landfillin e Sharrës duke ofruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate për këto familje nga Bashkia Tiranë dhe Fondacionit Alo Mik. Gjatë takimit pati konsultime mes aktorëve të përfshirë për integrimin e këtij komuniteti dhe 7 familjeve të komunitetit. Konsultimi u realizua me sukses duke bërë të mundur që këto familje nga ish banorë ne Land fillin e Sharrës të kenë mundësi të barabarta si të gjithë qytetarët e tjerë në marrjen e shërbimeve. Komuniteti Rom, i cili më parë ishte në skamje të plotë, tashmë ka mundësinë të jetojë në një shtëpi te tyren falë bonusit të qerave. Fondacioni Alo Mik prezantoi rezultatet e Programit të zhvilluar prej 12 vitesh, me përfshirje ditore ne terren dhe ndërtim te marrëdhënieve te besimit. Rreth 19 familje dhe 74 persona (te rritur dhe fëmije) janë përfitues te programit, si ish banore te Landfilli i Sharrës. Projekt aktualisht ka përfunduar hapin e gjashtë, dhe mbulon me shërbime 20 familje të komunitetit, nga të cilat 19 familje janë strehuar në shtëpi me qira, me zonën e Kombinatit, dhe 1 familje është kthyer në qytetin e origjinës në Shkodër, fëmijët e të cilës janë regjistruar dhe ndjekin shkollën publike.

- Agjencia në bashkëpunim me Ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Organizata Terre Des Hommes dhe UNICEF organizuan takimin për shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit, të cilët ndoqën kursin e 3-të të *Formimit të Vazhduar mbi “Çështjet e Mbrojtjes së Fëmijëve”*. Në këtë kurs kanë marrë pjesë punonjës të Njësiave për Mbrojtjen e Fëmijës, punonjës të institucioneve të përkujdesit social, punonjës social të organizatave që ofrojnë shërbime për fëmijë, punonjës të policisë, psikolog shkollor dhe punonjës të Agjencisë. 23 profesionistë finalizuan kursin duke ju bashkuar forcës së profesionistëve të Mbrojtjes së Fëmijëve . Ky kurs është organizuar gjatë viteve 2013-2016, për profesionistët në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

- Me 1 qershor në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Agjencia në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë, Bashkinë Tiranë dhe UNICEF organizuan aktivitetin Investojmë për fëmijët ! Sigurojmë të ardhmen ! Qëllim i aktivitetit ishte përforcimin e diskursit politik mbi rëndësinë e investimit në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës. Gjatë aktivitetit për herë të parë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve u nda një çmim për personin e vitit në mbrojtjen e fëmijës në dy kategori: Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Punonjës nga OJF që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve . Znj.Nadire Kreka Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashkinë Elbasan dhe Organizata Arsis u shpallen fitues për vitin 2017, si punonjësja dhe organizata e vitit

ne mbrojtjen e fëmijëve për përkushtimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm në mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës.

- Në bashkëpunim me partnerët, Agjencia ka përgatitur një paketë me materiale informuese me qëllim për të asistuar punën e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve në menaxhimin e rasteve, në koordinimin dhe ndërlidhjen me profesionistët e fushave të tjera, në sensibilizimin e profesionistëve, fëmijëve, prindërve dhe publikut për rëndësinë dhe mënyrat e raportimit të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve si dhe në organizimin e aktiviteteve provuese. Agjencia ka shpërndarë paketën informuese, broshurat “*Jo heshtjes!*” si dhe posterat drejtuar profesionistëve në të gjitha Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në vend. Posterat janë hartuar në kuadër të planit të mobilizimit #UnëMbrojFëmijët, janë 6 Postera, të cilët kanë për qëllim të qartësojnë rolin e institucioneve të sektorëve të ndryshëm në mbrojtjen e fëmijëve. 5 prej tyre i drejtohen institucioneve: 1) të arsimit; 2) të shëndetësisë, 3) të rendit, 4) të përkujdesjes shoqërore, 5) të njësisive të qeverisjes vendore. Posterat kanë si synim të afishohen në institucionet përkatëse, për të sensibilizuar profesionistët e këtyre institucioneve, por edhe fëmijët, prindërit dhe publikun e gjerë që u drejtohet atyre, mbi rolin e profesionistëve, rëndësinë e raportimit të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, dhe mënyrat e raportimit. Janë përgatitur rreth 5000 postera për profesionistët dhe 850 broshura “Jo heshtjes!”. Posterat dhe broshurat janë shpërndarë në 61 bashkitë e vendit. NJMF-të kanë shpërndarë dhe shpjeguar materialet në aktivitetet ndërgjegjësuëse apo informuese që kanë organizuara me aktorë vendor, fëmijë /nxënës në shkolla dhe komunitet. Posterat janë afishuar në institucionet përkatëse, për të sensibilizuar profesionistët e këtyre institucioneve, por edhe fëmijët, prindërit dhe publikun e gjerë që u drejtohet atyre, mbi rolin e profesionistëve, rëndësinë e raportimit të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, dhe mënyrat e raportimit.
- Më datë 8 qershor Agjencia në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës bashkia Kavajë ka organizuar takim sensibilizues për prezantimin e Posterit #UnëMbrojFëmijët në qendrën shëndetësore të bashkisë Kavajë. Qëllimi i aktivitetit ishte sensibilizimi i punonjësve të qendrave shëndetësore mbi rolin që ata kanë në mbrojtjen e fëmijëve dhe për raportimin e rasteve të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit apo dhunës tek fëmijët pranë Njësisive për Mbrojtjen e Fëmijës. Në takim morën pjesë punonjës të qendrave shëndetësore të bashkisë Kavajë.
- Agjencia në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës nr. 7 në muajin qershor organizoi takim ndërgjegjësuëse për prezantimin e posterit #Unë mbroj fëmijët në shkollë “Sabaudin Gabrani”. Qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe stafit pedagogjik në shkolla për të raportuar rastet e dhunës pranë autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës ose Policisë. Nxitja dhe bashkëpunimi ndërmjet shkollave dhe NJMF-së. U prezantuan posterit #Unë mbroj fëmijët në shkollë dhe Posterit “JO Heshtjes”, i cili përmban informacion për raportimin e rasteve të dhunës së fëmijëve duke përdorur një nga format e raportimit: telefono në numrin 116 111, në rast urgjence telefonon numrin 112, ose përdor aplikacionin #UnëMbrojFëmijët. Në aktivitet ishin të pranishëm nxënës, mësues dhe psikologjia e shkollës. Gjithashtu gjatë aktivitetit u prezantua dhe broshura jo heshtjes.
- Në kuadër të *Ditës Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi seksual*, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës zhvilloi takimin me temë “Mbrojtja e fëmijëve

ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual i lehtësuar nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit më përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime për fëmijë. Gjatë takimit u prezantua draft pyetësori tematik i Konventës së Lanzarotës, me temë: “Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i lehtësuar nga teknologjitë e komunikimit dhe informacionit” i cili plotësohet nga çdo shtet palë i Konventës Lanzarotës me qëllim finalizimin e raportit të Shqipërisë. Fokusi i pyetësorit janë imaget, videot dhe përmbajtjet me natyrë seksuale që prodhohen nga vete fëmijët. Gjithashtu, gjatë takimit u diskutua mbi sfidat e këtij zhvillimi teknologjik lidhur me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe çfarë mund të bëhet në të ardhmen në kuadër të Ligjit 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017- 2020.

## 8.2 Aktivitete informues për prezantimin e kuadrit të ri ligjor

Në kuadër të miratimit të ligjit nr. 18/2017” Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Agjencia ka pasur në fokus të punë së saj organizimin e takimeve informues me aktorët vendor, qendror dhe shoqërinë civile për prezantimin e kuadrit të ri ligjor.

Më 16 tetor 2017 Agjencia bashkëpunoi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për realizimin e një tryezë të rrumbullakët me tematikë “Dialogu me shoqërinë civile dhe aktet nënligjore të Ligjit 18/2017 " Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve " me qëllim sigurimin e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës për hartimin e kuadrit rregullator për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Ogerat Manastirliu. Kjo tryezë ofroi hapësirën për takimin e parë të Ministres Znj. Manastirliu me gamën e gjerë të aktorëve që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, për të përçuar mesazhet për këtë auditor dhe për një njohje fillestare me problematikat dhe shqetësimet e këtyre aktorëve.

Agjencia më 15 nëntor 2017, realizoi një sesion informues për organizatat lokale të cilat po veprojnë në kuadër të projektit 'Përfshirja e Shoqërisë Civile në Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre Des Hommes. Qëllimi i këtij takimi ishte edhe prezantimi i draftit të parë të VKM-së “ Për bashkëpunimin e mekanizmave dhe strukturave vendore dhe qendrore me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre”.

Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2017, Agjencia ka organizuar takime informuese për ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” në bashkitë Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastër, Korçë dhe Kukës. Qëllimi i organizimit të këtyre takimeve ishte informimin i të gjithë aktorëve, të cilët punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, lidhur me përgjegjësitë që ligji i ri parashikon për ta. Gjatë takimit u prezantuan risitë e ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” si dhe përgjegjësitë që krijohen për mekanizmat koordinues



këshillimorë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, masat e mbrojtjes dhe procedurat për marrjen në mbrojtje të fëmijës.

Në takimet e organizuara në bashkitë Fier, Elbasan Tiranë u konsultuan 2 projektvendime të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”:

1. Projektvendimi “Për Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes” ;
2. Projektvendimi “Për Funkcionimin e grupit teknik ndërsektorial”

Takimet në Bashkinë Shkodër dhe Gjirokastrë u organizuan në formën e ëorkshopeve në bashkëpunim me UNHCR dhe CARITAS. Përveç prezantimit të ligjit qëllimi i takimit ishte edhe forcimi i koordinimit institucional në identifikimin dhe referimin e rasteve në flukse murgatorë. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin aktorë lokal dhe policia kufitare të cilët bëjnë identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar në kufi.

### 8.3 Raportimet ndërkombëtare

Kryetari i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, përfaqëson shtetin Shqiptar në Komitetin Monitorues të Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (Komiteti i Lanzarotes), si dhe në Komitetin ad hoc për të Drejtat e Fëmijës (CAHENF) I cili është ngritur nga Komiteti i Ministrave në bazë të nenit 17 të Statutit të Këshillit të Evropës dhe në përputhje me Rezolutën CM / Res (2011) 24 mbi komisionet ndërqeveritare dhe organet vartëse, termat e tyre të referencës dhe metodat e punës.

Gjatë takimit të tretë të Komitetit Ad hoc për të Drejtat e Fëmijës (CAHENF) i cili u zhvillua në datat 22-24 nëntor 2017 u miratuan Udhëzimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në internet – dokument i cili pritet të miratohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në fillim të vitit 2018. Këto udhëzime do të shërbejnë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për hartimin e politikave në këtë fushë.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut vendi ynë do të paraqesë pranë Komitetit për të drejtat e Fëmijës (CRC) Raportin Periodik Kombëtar mbi Zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijës ” ratifikuar me Ligjin Nr.7531, datë 11.12.1991. Agjencia është pjesë e grupit ndërministror të punës ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr.112, datë 05.03.2014 “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, dhe do të bashkudhëheqës me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme procesin e hartimit të raportit periodik për CRC.

Agjencia është pjesë e grupit të punës për analizën e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian për kapitullin 23, lidhur me fushat e gjyqësorit, korrupsionit dhe të drejtave të njeriut. Agjencia ka përgatitur në kohë dhe me cilësi raportimet ndërkombëtare për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Raportimet për Raport Progresin për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, si dhe informacionet dhe raportimet e kërkuara në kuadër të Sesionit të 34 të KDNJ-së.

## KAPITULLI IX - REKOMANDIMET

- Ngritja e një sistemi efektiv gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve, zbatimi i parimeve të bashkëpunimit ndërsektorial dhe forcimi i aftësisë reaguese të sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhimit.
- Njohja dhe Zbatimi i ligjit të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” dhe detyrimet dhe standardet e reja ligjore për strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhimit ose potencialisht i tillë.
- Ngritja e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të jetë sipas standardeve të reja dhe në përputhje me ligjin e ri për shërbimet sociale si dhe ndarjen e re territoriale të vendit. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të jenë në çdo njësi administrative të bashkisë, me më shumë se 3000 fëmijë dhe në rastet kur ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të përcaktuar në përshkrimin e tij të punës.
- Në çdo bashki dhe njësi administrative duhet të funksionojë Grupi Teknik Ndërsektorial për trajtimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me pjesëmarrjen aktive të aktorëve të nevojshëm. Masat për aftësim prindëror duhet të jenë pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijëve.
- Formimi profesional i punonjësve të NJMF duhet të jetë si “punonjës social”, dhe në përputhje me dispozitat ligjore për pastërtinë penale të figurës së tij. NJMF duhet të ushtrojë autoritetin që i jep ligji duke bërë që interesi më i lartë i fëmijës të prevalojë mbi çdo interes tjetër, përfshirë dhe atë prindëror.
- Bashkitë duhet të hartojnë programe , projekte dhe plane lokale për respektimin e të drejtave të fëmijëve të buxhetuara nga fondi i bashkive. Bashkitë duhet të sigurojnë shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë nevojat për strehim, punësim dhe zhvillim urban të familjeve të varfra dhe pamundësi ekonomike.
- Duhet të rriten shërbimet me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës si dhe shërbimet mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes. Gjithashtu është e nevojshme zhvillimi i një sërë programesh dhe shërbimesh rehabilituese e riintegruese për fëmijët viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit fëmijët me nevoja të veçanta si dhe ata të përfshirë në vepra penale.
- Duhet të fuqizohen shërbimet ekzistuese dhe të ngrihen shërbime të reja për trajtimin rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve, të cilat deri tani janë mbështetur nga projektet e OJF-ve.

- Për fëmijët në rrezik të menjëhershëm, të neglizhuar rëndë, apo në situatë rruge duhet të merren masat emergjente për ta larguar fëmijën nga familja dhe situata e rrezikut dhe ta vendosur në përkujdesje alternative.
- Drejtuesit e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki duhet të ushtrojë përgjegjësinë për planifikimin e shërbimit aktiv të mbrojtjes emergjente 24-orësh si dhe monitorimin, koordinimin dhe raportimin për ecurinë e punës së Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës.
- Mësuesit dhe psikologët e shkollave, mjekë infermierë, punonjësit e institucioneve të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private dhe çdo profesionist në kontakt me fëmijën duhet të raportojnë për çdo rast dhune ndaj fëmijëve tek strukturat e mbrojtjes së fëmijës. Ndalimi e ndëshkimit trupor për fëmijët duhet të promovohet tek të gjithë profesionistët.
- Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës duhet të bëhen pjesë e trajnimeve për ndryshimet e reja ligjore dhe për ngritje kapacitetesh për mënyrën e raportimit, menaxhimin e rasteve që kërkojnë ndërhyrje specifike të kualifikuara.
- Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës duhet të trajnohen dhe të rrisin punën në drejtim të identifikimit në terren për e të gjitha rastet potenciale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Vizitat në familje duhet të jenë të qëllimshme për monitorimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e rasteve të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe në menaxhim.
- Të dhënat për mbrojtjen e fëmijëve, lidhur me mënyrën e menaxhimit të rasteve, duhet të dokumentohen dhe të ruhen sipas kërkesave të Udhëzimit 4 ministror nr.10. datë 25.2.2015. Është i nevojshëm digjitalizimi i të dhënave të NJMF si dhe vendosja e një sistemi unik për mbledhjen e tyre.
- NJMF-të duhet të përmirësojnë mënyrën e raportimit periodik pranë ASHMDF në përputhje me kërkesat e formularëve përkatës lidhur me të dhënat në shifra dhe mbi mënyrën e menaxhimit të rasteve të fëmijëve të menaxhuar.
- Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim me aktorë të tjerë dhe OJF duhet të rrisin ndërgjegjësimin e prindërve dhe fëmijëve, komunitetit për raportimin dhe denoncimin e rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve përmes linjave dhe aplikacioneve kombëtare të raportimit për fëmijët tek strukturat e mbrojtjes së fëmijëve.